



Kingdom of the Netherlands



Институт за човекови права



ANALIZË E THELLUAR

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT

PËRVOJA DHE PERSPEKTIVA

TITULLI

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut Përvoja dhe Perspektiva

EDITOR

Instituti për të Drejtat e Njeriut

REDAKTORI

Margarita Caca Nikollovska

AUTORË

Margarita Caca Nikollovska

Igor Spirovski

Martin Sopronov

REDAKTORE

Vesna Stefanovska

DIZAJNI FIGURATIV GRAFIK

Damjan Kanzurov

Gusht 2021, Shkup

Projekti "Gjykata Kushtetuese – Mbrojtëse e Sundimit të së Drejtës" është mbështetur nga Mbretëria e Holandës. Opinonet e prezantuara në këtë dokument janë opinione të autorëve dhe jo çdoherë i pasqyrojnë opinionet e donatorit.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
METODOLOGJIA	5
1. STATUSI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË RMV-së NË SISTEMIN JURIDIK	6
1.1. Pozita institucionale e Gjykatës Kushtetuese	7
1.2. Baza normative për rregullimin e statusit, mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese.....	8
1.2.3. Karakteri i Rregullores.....	8
1.3. Statusi i Gjyqtarëve Kushtetues.....	12
2. FUNKSIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE	15
2.1. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese	16
2.1.1. Kontrolli normativ i akteve të përgjithshme juridike.....	16
2.1.2. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	20
2.2. Procedura para Gjykatës Kushtetuese	25
2.3. Vendimmarja e Gjykatës Kushtetuese	27
2.4. Veprimi juridik i vendimeve	28
2.5. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	29
3. PUNA E GJYKATËS KUSHTETUESE	30
3.1. Efikasiteti	31
3.2. Transparenca dhe publiciteti.....	35
4. KONKLuzion	38
BIBLIOGRAFIA	42

HYRJË

Gjykatat kushtetuese janë autoritete të veçanta kushtetuese të cilat si kompetencë të tyre e kanë kontrollin mbi kushtetutshmërinë, ndërsa në disa vende edhe ligjshmërinë. Si rezultat i këtij roli të tyre të rëndësishëm në sistemet politike të shteteve ato paraqesin një element kyç të konstitucionalizmit që e nënkupton kundërpeshën (kufizimin) e supremacisë parlamentare dhe të pushtetit ekzekutiv në procesin e sendërtimit të pushtetit shtetëror dhe për vendosjen e sistemit të “demokracisë kushtetuese” të bazuar mbi supremacinë e Kushtetutës. Në këtë kuptim, njëri nga funksionet themelore të gjyqtarëve kushtetues konsiston me sigurimin e vlerës së parimit themelor të ndarjes së pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në një shoqëri demokratike, përkatësisht t’i kontrollojnë dhe mbajnë titullarët e këtyre pushteteve në kufijtë e prerogativëve të tyre kushtetues me qëllim të sendërtimit dhe zhvillimit të shoqërisë demokratike të bazuar në sundimin e të drejtës dhe liritë e njeriut.

Në Maqedoni gjyqësori kushtetues ekziston përafërsisht gjashtë dekada. Gjykata e parë Kushtetuese si institucion i veçantë i rendit kushtetues për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të tjera të përgjithshme është themeluar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë në vitin 1963. Ka filluar me punë më 15 shkurt të vitit 1964. Struktura e saj organizative, kompetenca e saj dhe procedurat e kryerjes së punëve në kompetencë të saj më për së afërmi janë rregulluar me ligj të veçantë. Bëhet fjalë për Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë i cili është miratuar kah fundi i vitit 1963, ndërsa ka hyrë në fuqi më datë 30 janar të vitit 1964. Gjykata Kushtetuese në përputhje me kompetencën ka ushtruar kontroll plotësues *a posteriori* ose kontroll kushtimisht thënë represiv mbi kushtetutshmërinë e ligjeve, me miratimin e vendimeve të cilat kanë pasur veprim juridik mbi konstatimin për jokushtetutshmërinë e ligjit, ndërsa nëse Parlamenti nuk e harmonizon ligjin në afat prej 6 muajsh, atëherë Gjykata Kushtetuese me vendim të ri konstaton se ligji pushon të vlejë. Gjykata Kushtetuese e ka pasur të drejtën të miratojë vendime shfuqizuese dhe anuluese për aktet nënligjore të cilat kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet, po ashtu, ka pasur të drejtë të vendos edhe për mbrojtjen e të drejtës së vet përcaktimit dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut të specifikuara në Kushtetutën e Jugosllavisë.¹

Me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë nga viti 1974 dhe Ligjin për bazat e procedurës dhe veprimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga viti 1976, u bënë ndryshime të vogla sa i përket kompetencës së Gjykatës dhe veprimit juridik të vendimeve të saj, megjithatë pozita e saj në raport me pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv mbeti e pandryshuar. Gjykata Kushtetuese ishte pjesë e sistemit unik të pushtetit dhe kishte për detyrë ta sigurojë harmoninë e brendshme të rendit juridik.

Gjykata Kushtetuese përsëri është pjesë e rendit të ri juridik të Republikës edhe me Kushtetutën e vitit 1991, me pozitë të ndryshuar të bazuar në demokraci, të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës.

Sipas nenit 108 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organi/autoriteti i Republikës e cila e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, dhe përmes saj edhe sundimin e të drejtës si njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës. Pozita, përbërja, kompetenca dhe veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), ndërsa mënyrën e punës dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese e rregullon Gjykata me akt të saj, përkatësisht me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese të

¹ Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë neni 233, Gazeta Zyrtare e RSM nr. 15/1963

RMV-së. Gjykata Kushtetuese sipas pozitës së saj nuk është pjesë e sistemit të organizimit të pushtetit shtetëror, por është një autoritet i veçantë kushtetues (sui generis) me status, përbërje, me organizim dhe kompetenca të përcaktuara në mënyrë konkrete me Kushtetutë. Pozita e pavarur e kështillë e Gjykatës Kushtetuese konsiderohet si supozim për ushtrimin papengesa të funksionit kushtetues-gjyqësor të mbrojtur nga ndikimet politike.

METODOLOGJIA

Qëllimi themelor metodologjik i Analizës së thelluar të Gjykatës Kushtetuese konsiston me krijimin e një teksti të qartë dhe preciz, i cili pa mëdyshje do t'u përgjigjet dyshimeve juridike të cilat ekzistojnë në teori dhe praktikë që kanë të bëjnë me pozitën dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Metodologjia përfshin dy komponentë si vijon: pjesën analitike dhe pjesën sintetike. Me pjesën analitike të analizës janë prezantuar elementë për perceptimin e gjendjes, përkatësisht elementë për sintezën. Rezultati i perceptimit të gjendjeve (sinteza) është gjendja aktuale – pozita e Gjykatës Kushtetuese si pjesë e sistemit kushtetues në RMV.

Me analizën normative janë përfshirë normat – dispozitat e Kushtetutës të RMV me të cilat është rregulluar pozita e Gjykatës Kushtetuese në rendin Kushtetues të Republikës, statusi kushtetues i gjyqtarëve brenda saj, kompetenca e saj dhe çështje të tjera në lidhje me pozitën dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese si pjesë e sistemit kushtetues të Republikës.

Pastaj, me këtë analizë, janë shqyrtuar dispozitat e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese si akt sui generis për rregullimin e mënyrës së punës dhe procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Rregullorja përmban dispozita – norma me domethënie të përgjithshme për Gjykatën Kushtetuese; pastaj dispozita për mënyrën e punës së Gjykatës, për procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve normative dhe të akteve tjera të përgjithshme, për procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga neni 110, alineja 3 të Kushtetutës; për procedurën e heqjes së imunitetit, për përcaktimin e përgjegjësisë dhe për përcaktimin e krijimit të kushteve për ndërprerjen e funksionit të Presidentit të Republikës; për procedurën e zgjidhjes së konfliktit të kompetencës dhe dispozita të tjera të rëndësishme për kryerjen e punëve në kompetencë të Gjykatës.

Përmes analizës së punës së Gjykatës Kushtetuese intenca është të ofrohet një panoramë e qartë lidhur me efikasitetin, transparencën dhe publicitetin e saj. Për këtë qëllim ekipi i përbërë nga dy juristë e monitoroi punën e Gjykatës në seancat publike, brenda periudhës kohore nga data 1.9.2020 deri më datë 31.8.2021. Qëllimi i monitorimit të seancave të Gjykatës është grumbullimi i të dhënave statistikore për punën e Gjykatës Kushtetuese, siç është numri i lëndëve të marra në punë në periudhën e raportimit (kërkesa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, iniciativa për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë etj.), numri i seancave të organizuara përgatitore dhe numri i diskutimeve publike dhe shkalla e iniciativave dhe kërkesave të pranuar, të refuzuara dhe të hedhura poshtë, me një qëllim të vetëm që të përcaktohet efikasiteti i punës me lëndët.

Të dhënat e fituara nga monitorimi i punës së Gjykatës janë përpunuar në bazë të Metodologjisë paraprakisht të përcaktuar dhe janë prezantuar para publikut përmes tre raporteve për punën e Gjykatës Kushtetuese (një raport katërmujor dhe dy raporte tremujore).



1

**STATUSI I
GJYKATËS
KUSHTETUESE
TË RMV-SË
NË SISTEMIN
JURIDIK**

POZITA INSTITUCIONALE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Pozita e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së është përcaktuar konform dispozitave të Kushtetutës së RM-së nga viti 1991, ndërsa më për së afërmi është rregulluar me aktin (Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese) e miratuar nga ky autoritet. Kompetenca e Gjykatës për miratimin e një akti të këtillë buron nga neni 113 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me të cilin, me akt të Gjykatës, rregullohet mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese.

Sipas nenit 108 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organi/autoriteti i Republikës e cila e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.²

Gjykata Kushtetuese është **autoritet shtetëror sui generis** me **reputacion të lartë**. Bëhet fjalë për një **autoritet shtetëror** meqë Kushtetuta ia përcakton këtë cilësi dhe konform nenit 112 të Kushtetutës vendimet e saj për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë janë të detyrueshme, përfundimtare dhe ekzekutive për të gjitha subjektet juridike. Kundër të njëjtave nuk lejohet ankesë. Paragrafi 3 i këtij neni, i cili ka të bëjë me veprimin e vendimeve të Gjykatës, aludon për të gjitha vendimet që i miraton, dhe jo vetëm për vendimet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në këtë segment janë përfshirë edhe vendimet për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, konfliktin e kompetencave dhe përgjegjësinë e Presidentit.

Gjykata Kushtetuese është **e pavarur nga autoritetet e tjera të pushtetit shtetëror**. Në punën e saj ajo është e pavarur nga Kuvendi, nga Presidenti i Republikës, nga Qeveria dhe nga gjykatat e rregullta. Së këtejmi, Gjykata Kushtetuese pozicionohet në nivelin e autoritetit më të lartë për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe nga ky aspekt përmes kompetencës së saj i kontrollon pushtetet e tjera.

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë gjyqtarë. Me rëndësi jashtëzakonisht të madhe është që gjyqtarët kushtetues të jenë të pavarur në punën e tyre, dhe së këtejmi, Kushtetuta në nenin 111 siguron mekanizma për garantimin e pozitës së pavarur të gjyqtarëve nga bartësit e pushtetit në Republikë.³ **Pozita e Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës dhe e ripërcaktuar me Rregulloren, gjykatës ia mundëson pavarësinë funksionale.**

2 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 52, e premte 22 nëntor, 1991

3 Spirovski, Igor, "The Independence of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia: Guarantees and Challenges" Venice Commission - World Conference of Constitutional Justice, Rio https://www.venice.coe.int/WCCJ/Rio/Papers/MKD_Spirovski_E.pdf

1.2.

BAZA NORMATIVE PËR RREGULLIMIN E STATUSIT, MËNYRËS SË PUNËS DHE PROCEDURËS PARA GJYKATËS KUSHTETUESE

1.2.1. KARAKTERI I RREGULLORES

Në praktikën e gjykatave kushtetuese mënyra e punës dhe procedura para tyre rregullohet me ligj ose me rregullore.

Në rajonin e Evropës Juglindore thuaja se të gjitha shtetet kanë ligj për Gjykatën Kushtetuese përveç Bosnjë e Hercegovinës dhe Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës parashikohet se “mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me akt të Gjykatës”.

Në bazë të kësaj dispozite kushtuese u miratua Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese. Krahas dispozitave të përgjithshme, Rregullorja përmban: dispozita për mënyrën e punës të Gjykatës Kushtetuese; për procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve normative dhe të akteve tjera të përgjithshme; për procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga neni 110 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut; për procedurën e heqjes së imunitetit, për përcaktimin e përgjegjësisë dhe për përcaktimin e krijimit të kushteve për ndërprerjen e funksionit të Presidentit të Republikës; për procedurën e zgjidhjes së konfliktit të kompetencës; për procedurën e heqjes së imunitetit dhe për konstatimin e humbjes së përhershme të zotësisë për të vepruar në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese; për aktet e Gjykatës; për veprimin juridik të vendimeve të Gjykatës; për transparencën në punën e Gjykatës; për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës; për bashkëpunimin e Gjykatës me gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera; për organizimin e brendshëm të Gjykatës dhe dispozita të tjera të rëndësishme për kryerjen e punëve në kompetencë të Gjykatës. Është evidente se bëhet fjalë për dispozita pjesa më e madhe e të cilave kanë të bëjnë me mënyrën e punës dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese (dispozita procesuale) ashtu siç e përcakton dispozita e theksuar në nenin 113 të Kushtetutës.

Sipas mendimit të autorëve të caktuar, për dallim nga dy kushtetutat paraprake, Kushtetuta e vitit 1991, ka hequr dorë nga rregullimi më i gjerë kushtetues dhe ligjor të mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese, ndërkaq rregullimin e kësaj materie e ka sanskionuar në **aktin e Gjykatës Kushtetuese**. Qasja e këtillë e kushtetutëbërësit në masë të konsiderueshme e redukton legjitimitetin dhe reputacionin e Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e funksionit të mbrojtësit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në rendin kushtetues të Republikës.⁴

4 Shkariq Svetomir. “E drejta Kushtetuese komparative dhe maqedonase, Matica makedonska”, 2004, f. 685

Në këtë drejtim, duhet të jenë të qarta ose të sqarohen disa çështje.

Së pari, kriter për përcaktimin e natyrës juridike, karakterit dhe vlefshmërisë normative të “Rregullores së Gjykatës Kushtetuese” nuk është emërtimi i atij Akti, por autorizimi kushtetues që Gjykata Kushtetuese të miratoj Akt për rregullimin e “mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese”. “Akti” nga neni 113 mund të ketë edhe emërtim tjetër, për shembull, “Rregulla të Gjykatës Kushtetuese”, ose “Rregulla për mënyrën e punës dhe procedurës pra Gjykatës Kushtetuese” (e që nga ana tjetër korrespondon me termin “Rregullore” si përkthim i zakonshëm i termit “Rules of Court”, „Rules of Procedure” – kjo e fundit veçanërisht kur bëhet fjalë për Rregullore të Kuvendit). Së këtijmi, vlerësimi për atë se çka mundet dhe çka nuk mund të rregullohet me “Aktin” të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113 të Kushtetutës, të bazuar në perceptimin e këtij akti si “rregullore” në kuptimin administrativ, mbështetet në supozimin e gabuar evident, jo thelbësor dhe së këtijmi supozim formal me të cilin injorohet neni 113 i Kushtetutës.

Së dyti, që një akt i përgjithshëm ta ketë karakterin e “aktit normativ nënligjor” duhet që miratimi i tij të rezultojë si autorizim i përcaktuar në ligj. Megjithatë, “Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese” në asnjë mënyrë nuk është akt normativ “nënligjor” të këtij tipi. Akti i Gjykatës Kushtetuese nga neni 113 të Kushtetutës dhe përfshirja e rregullimit të tij, si dhe autorizimi i Gjykatës Kushtetuese që ta miratojë, burojnë drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, pa ndërmjetësim me ligj. Në këtë kontekst, duhet të jetë e qartë se “akti i Gjykatës Kushtetuese për mënyrën e punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese, i cili tani është emërtuar si “Rregullore”, është akt i përgjithshëm juridik me **status autonom sui generis** në rendin kushtetues me përfshirjen e qartë të objektit të rregullimit. Me këtë nuk sugjerohet se Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese në kuptimin formal barazohet ose e ka rankun e ligjit (kjo është e pamundur nga pikëpamja e bartësit të vetëm të pushtetit ligjvënës), por vetëm atë se çështjet që i rregullon janë fushë autonome e kompetencës normative të Gjykatës Kushtetuese që i është ndarë me Kushtetutë. Në këtë drejtim, do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën të miratohet ligj me të cilin do të rregullohej “mënyra e punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese”. Dëshira e një pjese të publikut profesional çështjet nga neni 113 të Kushtetutës të rregullohen formalisht me ligj (ose me ligj kushtetues) aspak nuk e vë në pikëpyetje legjitimitetin kushtetues të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, kështu derisa nuk ndryshohet neni 113 i Kushtetutës. Ndërsa për një ndryshim të këtillë nevojiten argumente serioze, të cilët për momentin vështirë mund të identifikohen.

Së treti, kritika se me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese rregullohen çështje të cilat “nuk e kanë vendin në një rregullore”, si për shembull veprimi juridik i vendimeve të saj, duhet të perceptohet edhe në dritën e argumenteve që prezantohen në mbështetje të kësaj teze por, para së gjithash, nga argumente të cilat rezultojnë nga Kushtetuta, ndërsa të njëjtat nuk perceptohen në masë të mjaftueshme. Siç është theksuar në vijim, shqetësimi nga ajo se “rregullorja paska natyrë interne, se është akt me rankim më të ulët në hierarkinë e akteve normative juridike dhe ngjashëm është argument formal të mos themi formalistik, i cili është i pamjaftueshëm, madje edhe kur vlerësohet vetëm nga aspekti i nenit 113 të Kushtetutës dhe në të vërtetë është manifestim i mos dakordësimit me konceptin e nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese me këtë akt autonom ta rregulloj mënyrën e punës së vet dhe procedurën para Gjykatës. Megjithatë, zgjidhjet esenciale të Kushtetutës, veçanërisht për veprimin juridik dhe detyrimin dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, bëjnë fjalë për atë se Gjykata Kushtetuese në Rregullore u përmbahet kufijve të autorizimeve të saj nga neni 113.

Nëse e ndjekim kompetencën e Gjykatës Kushtetuese në nenin 110 të Kushtetutës nuk mund të jetë e paqartë se çfarë vendimi do të miratojë Gjykata në mënyrë që ta përmbush detyrimin e vet kushtetues të vendos për çështjet që i ka në kompetencë.

Krahas vendimeve shfuqizuese dhe anuluese me të cilat Gjykata Kushtetuese **i eliminon** nga rendi juridik ligjet të cilët nuk korrespondojnë me Kushtetutën dhe aktet e tjera të përgjithshme të cilat nuk korrespondojnë me Kushtetutën dhe/ose me ligjin (neni 112), gjithsesi se Gjykata Kushtetuese mundet dhe medoemos duhet të miratojë vendim shfuqizues ose anulues me të cilin **do të eliminojë** nga rregullimi juridik ndonjë akt individual me të cilin janë shkelur disa nga liritë dhe të drejtat nga neni 110 alineja 3 të Kushtetutës për mbrojtjen e të cilave është e autorizuar dhe e ka detyrimin me Kushtetutë, përndryshe nuk mund ta ushtrojë kompetencën e saj. Pastaj, lloji i vendimit me të cilin Gjykata vendos “për konfliktin e kompetencës” në të vërtetë është përfshirë, përcaktuar në definicionin e kësaj kompetence (me vendimin do të përcaktoj se kush nga bartësit e pushtetit ose vetëqeverisja lokale është kompetente një gjë të këtillë Kushtetuta e kërkon nga ajo). Vendimi për përcaktimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës dhe veprimi i tij juridik janë përcaktuar në nenin 87 të Kushtetutës. Po ashtu, në nenin 82 të Kushtetutës është përcaktuar edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për krijimin e kushteve për ndërprerjen e funksionit President i Republikës në rast të vdekjes, dorëheqjes, pengesës së përhershme ose ndërprerjes së mandatit me fuqinë e Kushtetutës. Kur dispozitat e Rregullores perceptohen në këtë kontekst kushtetues është e qartë se Gjykata Kushtetuese me Rregulloren nuk shpikë lloje të vendimeve dhe as që merr autorizime më të mëdha prej atyre që i janë ndarë me Kushtetutë.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, nuk është vështirë të konkludohet se parimisht Rregullores nuk i mungon baza dhe legjitimiteti kushtetues për rregullimin e çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me procedurën para Gjykatës Kushtetuese; se lloji dhe veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese burimisht janë rregulluar me Kushtetutën; si dhe ajo se në Rregullore nuk trajtohet “materia ligjore” (*përveç shtesës së pagës së gjyqtarëve që gjithsesi nuk mund të jetë pjesë e aktit të nenit 113 të Kushtetutës*). Së këtejmi, padyshim se çështje të caktuara, jashtë mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese, duhet të rregullohen me ligj, siç ka qenë çdoherë në të kaluarën ashtu edhe sot: pagat dhe kompensimet e ndryshme të gjyqtarëve, të drejtat e gjyqtarëve pas ndërprerjes së funksionit etj. gjithsesi se nuk janë mënyrë e punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese dhe medoemos duhet të rregullohen me ligj. Në këtë kuptim nevoja për miratimin e Ligjit të veçantë për Gjykatën Kushtetuese theksohet edhe në Raportin përfundimtar të **Misionit të ekspertëve të TAIX** për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga viti 2018 të Jasna Omejec në të cilin theksohet “Në lidhje me statusin e veçantë kushtetues të Gjykatës, si dhe fakti se vendi nuk ka ligj të veçantë, ekzistojnë shkaqe plotësisht të arsyeshme të miratohet një ligj i veçantë me të cilin do të rregullohen **pagat dhe kontratat e tjera të punës së gjyqtarëve të GJK** (kompensime dhe të ardhura të tjera personale, periudha e punësimit, sigurimi social, pushimi vjetor dhe ditë tjera të lira, të drejtat e tyre pas ndërprerjes së mandatit etj.)”⁵ Por kjo nuk do të thotë se duhet të miratohet me çdo kusht “Ligji për Gjykatën Kushtetuese” i cili do ta “gëlltisë” edhe materien që ka të bëjë me mënyrën e punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese që rregullohet me akt të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113 të Kushtetutës. Sa u përket opinioneve të prezantuara në Raportin e Misionit të ekspertëve TAIX, duhet të theksohet se kjo materie tanimë pjesërisht është rregulluar me Ligjin për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë. Konsiderojmë se është pozitive këto çështje të rregullohen me një akt por shtrohet pyetja sa do të jetë efikase, që për këtë shkak të ndryshohet Kushtetuta. Çështjet e pagave dhe shtesat në pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhen me dispozita të veçanta të cilat janë përfshirë në një kapitull të veçantë në

5 Omejec, Jasna. “Raporti përfundimtar Misioni i ekspertëve të TAIX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese”, Shkup, shkurt 2018 (në gjuhën maqedonase) f. 29, Konkluzion, numër 6

Ligjin për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë.

Komisioni i Venecias në Opinionin e tij CDL-AD(2014)026 nga 13 tetori 2014, thekson: “do të ishte e dobishme të miratohet një ligj i veçantë për Gjykatën Kushtetuese me të cilin do të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me **statusin e gjyqtarëve të saj, kushtet themelore për ngritjen e procedurës para Gjykatës Kushtetuese, veprimin juridik të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese**, etj.⁶ Referimi ndaj një ligji të këtillë duhet të inkorporohet në Kushtetutë, që do të thotë se në mënyrë përkatëse duhet të shtohet një paragraf i ri në nenin 113. Megjithatë, nënkuptohet se miratimi i një ligji të këtillë nuk guxon të ndikojë mbi kompetencën e Gjykatës Kushtetuese që t’i rregullojë metodat e saj të punës dhe ta shqyrtojë Rregulloren e punës në Rregulloren e Gjykatës”⁷

Me respektin e plotë ndaj Komisionit të Venecias, me sa duket gjatë formulimit të Opinionit në fjalë, Komisioni nuk i ka pasur parasysh në masë të nevojshme aspektet e prezantuara të rregullimit të këtyre çështjeve në Kushtetutë dhe në Rregullore, që i relativizon përpjekjet për miratimin e ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Miratimi i një ligji të këtillë integral, me ndryshimin paraprak të nenit 113 të Kushtetutës, sipas konkluzionit të kësaj analize **aspak nuk është e nevojshme**. Për më tepër, siç është prezantuar, statusi dhe veprimi juridik i veprimeve të Gjykatës janë rregulluar në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, ndërsa procedura para Gjykatës Kushtetuese është rregulluar, para së gjithash, nga aspekti procedural në Rregullore, në bazë të kompetencës të dhënë nga Kushtetuta në nenin 113. Veprimi juridik i vendimeve është përcaktuar në nenin 112 të Kushtetutës, në lidhje me kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme. Si diçka që mund të problematizohet në këtë segment është veprimi juridik i vendimeve sa u përket kompetencave të tjera nga neni 110 të Kushtetutës, meqë neni 112 nuk përcakton se çfarë vendime do të miratohen në lidhje me këto kompetenca, megjithatë teoria dhe praktika juridike është e qartë se në cilin drejtim duhet të lëvizë sjellja e Gjykatës Kushtetuese dhe akoma më shumë se kjo çështje është rregulluar me Rregulloren. Domethënia e vendimeve me veprim anulues ose shfuqizues është botërisht e njohur dhe nuk ka nevojë që të njëjtat të përcaktohen sërish me ligj.

Përveç kësaj, bartja e rregullimit normativ të procedurës para Gjykatës Kushtetuese nga akti autonom i Gjykatës në ligj, mund të hap mundësi për ndikim dhe kontroll të caktuar të ligjvënësit mbi aspektet esenciale të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, madje deri në nivelin e kufizimit të veprimit juridik dhe efekteve të vendimeve të saj, gjë e cila nuk është e panjohur në praktikën komparative “negative” (për shembull, kufizimi i veprimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë të bëjnë me çështje financiare dhe buxhetore dhe ngjashëm). Zgjidhja ekzistuese, me sa duket, siguron **supozim solid për shkallën e lartë të autonomisë dhe pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese** në ushtrimin e funksioneve të saj e që nuk duhet të vihet në rrezik.

6 Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD(2014)026 f. 17 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)026-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)026-e)

7 Omejec, Jasna. *supra note. 5, f. 15*

STATUSI I GJYQTARËVE KUSHTETUES

Statusi i pavarur i Gjykatës Kushtetuese veçanërisht vjen në shprehje përmes pozitës së pavarur të funksionit të gjyqtarit kushtetues. Në sigurimin e statusit të pavarur të gjyqtarit kushtetues ndikojnë faktorët si vijojnë: kohëzgjatja e mandatit të tij, i përcaktuar me Kushtetutë; pamundësia për rizgjedhje eventuale; papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit dhe imuniteti të cilin e gëzon si anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe siguri i mjeteve financiare dhe niveli i pavarësisë gjatë shpenzimit të këtyre mjeteve.

Statusi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar me Kushtetutën e RMV-së dhe më për së afërmi është rregulluar me Rregulloren e Gjykatës.

Sipas nenit 109 dhe Amendamentit 15 të Kushtetutës gjyqtarët i zgjedhë Kuvendi nga radha e juristëve të spikatur, me mandat 9 vjeçar pa të drejtë për rizgjedhje. Gjyqtarët kushtetues e zgjedhin kryetarin e Gjykatës nga radhët e veta, që e përforcon pavarësinë e gjyqtarëve. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i zgjedhë Kuvendi me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Përbërjen e Gjykatës e propozon Kuvendi i RMV-së, Presidenti i Republikës dhe Këshilli Gjyqësor i RMV-së, në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese. Nga kjo që u tha më lartë, rezulton se gjatë përcaktimit të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese shmanget mundësia për ndikim nga ana e ndonjë autoriteti shtetëror ose partie politike.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radha e **juristëve të spikatur**, duke e inkorporuar këtë dispozitë në Kushtetutën e RMV-së si kriter për zgjedhje, është i qartë vullneti i kushtetutëbërësit për reduktimin e ndikimit politik në zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Nocioni jurist i spikatur nuk është definuar me Kushtetutë.⁸ Megjithatë, nuk ka nevojë për një përkufizim të këtillë sepse nevojitet vetëm interpretim i drejtë i të njëjtit. Njëkohësisht nuk ka nevojë për ndonjë sqarim të këtij nocioni nëse i njëjti interpretohet në mënyrë përkatëse. Propozuesit e kanë obligimin të paraqesin prova dhe argumente. Pse një person i caktuar e meriton epitetin jurist i spikatur, ndërsa Kuvendi i cili e bën zgjedhjen e gjyqtarëve duhet të vendos se argumentet e prezantuara a janë të pranueshme.

Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet pa të drejtë për rizgjedhje. Mandati i vendosur i këtillë të gjyqtarëve kushtetues ofron garanci se një strukturë në pushtet nuk mund t'i zgjedh të gjithë gjyqtarët kushtetues. Në mënyrë plotësuese, mandati më i gjatë i gjyqtarëve kushtetues e siguron vazhdimësinë në punën e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa pamundësia për rizgjedhje ndikon mbi fuqizimin e pavarësisë gjatë miratimit të vendimeve të gjyqtarit.

Në nenin 111 të Kushtetutës përcaktohet që funksioni i gjyqtarit të jetë i papajtueshëm me funksionin politik ose me funksion tjetër, gjyqtarët kanë imunitet. Për imunitetin e tyre nuk vendos subjekti jashtë Gjykatës Kushtetuese, por vet Gjykata, që e përforcon pavarësinë e tyre, si dhe atë se gjyqtarët nuk i nënshtrohen detyrimit për Forcat e armatosura.

Në përputhje me këtë dispozitë të Kushtetutës në mënyrë të qartë është përcaktuar se **funksioni gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese është funksion i depolitizuar dhe është i papajtueshëm me funksione dhe profesione të tjera publike.**⁸

⁸ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 52, e premte 22 nëntor, 1991.

Rregullat që kanë të bëjnë me institutin e papajtueshmërisë së funksionit Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese e kanë për qëllim ta garantojnë pavarësinë e gjyqtarit dhe angazhimin e tij të plotë në punën e Gjykatës.

Me nenin 10 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese më për së afërmi rregullohet çështja e imunitetit, në përputhje me dispozitat kushtetuese. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet si edhe deputetët në Kuvendin e RMV-së, të përcaktuar me Kushtetutë.

Duke u thirrur në të **drejtën e imunitetit** të deputetëve, i cili është përcaktuar konform nenit 64 të Kushtetutës, imuniteti i gjyqtarëve kushtetues është rregulluar me nenin 111 të Kushtetutës, ndërsa më për së afërmi trajtohet me nenin 10 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese. Sipas kësaj që u tha më lartë, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e prezantuar ose për votimin në Gjykatë, ai nuk mund të arrestohet pa lejen e gjykatës, përveç nëse është kapur në flagrancë në kryerjen e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vjet. Imuniteti e mbron gjyqtarin kushtetues madje edhe atëherë kur ai vet nuk është thirrur në imunitetin e tij, nëse kjo është e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij dhe funksionit të Gjykatës, dhe në atë rast për aplikimin e imunitetit, nënkuptohet, vendos Gjykata, e cila e garanton pavarësinë e tij.

Në përputhje me nenin 111 të Kushtetutës, shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga detyra pa vullnetin e tij mund të bëhet vetëm me përjashtim. Deri në këtë, sipas Kushtetutës, mund të vijë kur do të krijohen rrethana të caktuara objektive: nëse gjyqtari dënohet për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me burgim prej më së paku gjashtë muaj ose kur ai për çdoherë do ta humbë zotësinë për të vepruar gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Sipas kësaj, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mund t'i ndërpritet funksioni para skadimit të mandatit kur ai do ta vë vetveten, me veprën e tij, në situatë e cila e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit ose kur do të krijohen rrethana objektive për shkak të të cilave ai nuk është në mundësi ta ushtroj funksionin.

Ekzistimin e fakteve për ndërprerjen e funksionit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për shkak të humbjes së përhershme të zotësisë për të vepruar gjatë ushtrimit të funksionit si dhe ekzistimin e fakteve për heqjen e imunitetit të gjyqtarit e përcakton Gjykata Kushtetuese. Sipas nenit 67 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese për përcaktimin e humbjes së përhershme të zotësisë për të vepruar të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për ushtrimin e funksionit të tij, si dhe për heqjen e imunitetit të tij, vendos Gjykata Kushtetuese në seancë.

Në Kushtetutë dhe Rregullore **nuk është parashikuar mundësia e përjashtimit të gjyqtarëve**. Kur bëhet fjalë për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese sa i përket kontrollit normativ të kushtetutshmërisë dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, nuk ka shkak dhe nevojë të arsyeshme për përjashtim, përveç nëse gjyqtari në mënyrë të drejt-përdrejt ka marr pjesë në miratimin e ligjit, të dispozitës konkrete nga ligji ose në miratimin e ndonjë akti tjetër i cili është kontestuar para Gjykatës Kushtetuese. Eventualisht, tek kompetenca për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, çështja e përjashtimit të gjyqtarëve duhet të trajtohet në çdo rast konkret veç e veç, varësisht nga rrethanat që duhet të shqyrtohen, si intervenim në liritë dhe të drejtat e dhëna. Përjashtimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të rregullohet me Rregulloren e Gjykatës, me kërkesë të palëve në procedurën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe me kërkesë të vet gjyqtarëve, gjithsesi përmes prezantimit të argumenteve. Vendimin për përjashtim mund ta miratoj kryetari i Gjykatës ose me propozim të tij vendimin mund ta miratojnë gjyqtarët. Eventualisht, si problem këtu mund të paraqitet plotësimi i numrit të gjyqtarëve të përjashtuar, nëse në procedurën përjashtohen më shumë gjyqtarë. Ky problem mund të tejkalohet përmes zgjedhjes “ad hoc” të gjyqtarëve nga ana e Kuvendit, në mënyrë të njëjtë si edhe në procedurën e rregullt.

Pozita materiale e gjyqtarëve kushtetues është një kusht i rëndësishëm për pavarësinë e tyre, e që shprehet me autonominë e plotë financiare të Gjykatës Kushtetuese. Në rastet kur nuk ka autonomi të këtillë dhe kur për financimin e Gjykatës vendos Parlamenti, përkatësisht Qeveria, është evidente se ekziston ndikim më i madh i këtyre institucioneve mbi punën e Gjykatës Kushtetuese.

Ekspertët e **Komisionit të Venecias** në Raportin për pavarësinë e gjyqtarëve (CDL-AD(2010)004) janë të mendimit se niveli i të ardhurave të gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj, në përputhje me dinjitetin e funksionit të tyre dhe vëllimin e detyrave të tyre, dhe të gjitha kompensimet e tjera të cilat e përfshijnë elementin e diskrecionit absolutisht duhet të ndërpriten.

Pozita materiale e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, para së gjithash, përcaktohet me të ardhurat e tyre. Sipas nenit 32, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut çdo i punësuar e ka të drejtën për të ardhura përkatëse. Përkatëse janë ato të ardhura të cilat korrespondojnë me numrin dhe vëllimin e punëve dhe detyrave të vendit të punës, me kompleksitetin e tyre, me përgjegjësinë e cila rezulton nga rëndësia e tyre shoqërore dhe nënkuptohet me vëllimin dhe cilësinë e performancës gjatë kryerjes së detyrave të punës. Duke gjykuar sipas dispozitave të Rregullores për punët dhe detyrat të cilat i kryejnë gjyqtarët, ato janë komplekse dhe vëllimore.

Të ardhurat përbëhen nga paga, shtesat në pagë dhe kompensimet në pagë.

Pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me **Ligjin për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë (Ligji për pagat)**.

Nëse bëjmë një krahasim midis gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve në gjykatat e rregullta rezulton se, sipas Ligjit për pagat e gjyqtarëve (neni 7-b), gjyqtarët në gjykatat e rregullta kanë të drejtë për shtesa në pagë edhe atë: shtesë për kushte të veçanta të punës, shtesë për ekzistimin e rrezikut të lartë dhe shtesë për konfidencialitetin. Shuma e përgjithshme e lartësisë së këtyre shtesave mund të jetë deri në 35% nga paga themelore e gjyqtarit të gjykatës së rregullt. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në përputhje me Ligjin për paga nuk kanë të drejtë për shtesa të këtilla, ndërsa padyshim duhet ta kenë. Megjithatë parashtrohet pyetja si të rregullohet kjo materie.

Sipas Ligjit për pagat e gjyqtarëve, gjyqtari i gjykatës së rregullt e ka të drejtën e pagës e cila korrespondon me rëndësinë dhe reputacionin e funksionit të gjyqtarit të cilin e ushtron, rëndësinë e punës dhe me përgjegjësinë e tij. Një situatë e këtillë është parashikuar për kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në Ligjin për paga kur përcaktohet koeficienti i pagave të tyre. Me Ligjin për paga për të njëjtit nuk janë përcaktuar shtesa për kushte të veçanta të punës, për rrezikun e lartë dhe shtesa për konfidencialitet si dhe për rrethanat e lartësisë së këtyre shtesave. **Shtesat e këtilla janë përcaktuar me Rregullore, e që sipas mendimit tonë nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe të njëjtat duhet të përcaktohen në Ligjin e theksuar më lartë.**

Në këtë drejtim është edhe Opinioni i Komisionit të Venecias, sipas të cilit “nuk është në përputhje me pozitën e Gjykatës Kushtetuese, ajo të mos konsiderohet për gjykatë në të cilën mund zbatohet parimi i pavarësisë së gjyqësorit.” Në mënyrë përkatëse me këtë, me sa duket, është i saktë konkluzioni i Komisionit të Venecias si vijon: “Nëse ligjvënësi është udhëhequr nga parimi i pavarësisë së gjyqësorit, duke implikuar se pagat e gjyqtarëve nuk mund të zvogëlohen në gjendje krize, atëherë parimi i njëjtë doemos duhet të zbatohet edhe tek gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (CDL-AD(2010) 038-e).⁹

9 Opinioni i Komisionit të Venecias (CDL-AD(2010) 038-e) f.6 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2010\)038](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2010)038)



2

**FUNKSIONI
I GJYKATËS
KUSHTETUESE**

2.1.

KOMPETENCA E GJYKATËS KUSHTETUESE

Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me kompetencën e saj reale, përkatësisht me autorizimet e saj konkrete të cilat në mënyrë taksative janë përcaktuar në nenin 110 të Kushtetutës së RMV-së, të specifikuara në pesë grupe të çështjeve: kontrolli normativ i akteve të përgjithshme juridike, mbrojtja e drejtpërdrejt e lirive dhe të drejtave kushtetuese të njeriut dhe qytetarit, zgjidhja e kontesteve lidhur me kompetencën midis autoriteteve shtetërore dhe zgjidhja e kontesteve midis autoriteteve shtetërore dhe njësisë të vetëqeverisjes lokale, vendimmarrja për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, vendimmarrja për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve dhe vendimmarrja për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.¹⁰

Kompetenca e saj vendore e përfshinë territorin e mbarë Republikës meqë ajo si autoritet sui generis për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është autoriteti i vetëm në Republikë.

2.1.1. KONTROLLI NORMATIV I AKTEVE TË PËRGJITHSHME JURIDIKE

Kontrolli normativ i akteve të përgjithshme juridike është funksioni kryesor i Gjykatës Kushtetuese. Ky funksion i saj i parashikuar në nenin 110 të Kushtetutës realizohet përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve tjera normative dhe akteve të përgjithshme.

Përmes kontrollit normativ Gjykata Kushtetuese në të vërtetë e kontrollon kushtetutshmërinë e të drejtës pozitive, përkatësisht e mbron të drejtën e supremacisë të Kushtetutës në rendin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Kushtetuese e RMV-së në përputhje me nenin 110 alineja 2 të Kushtetutës është kompetente të vendos për aktet e tjera normative dhe kontratat kolektive se a korrespondojnë me Kushtetutën dhe me ligjet. Kompetenca e vlerësimit të ligjshmërisë është një shembull i rrallë dhe madje unik në të drejtën komparative, me ç'rast Gjykatës Kushtetuese i është përcaktuar kjo kompetencë. Më së shpeshti, kompetenca për vlerësimin e ligjshmërisë është në duart e gjykatave të rregullta. Në praktikën vendore, ekziston prezumimi kushtetues gjatë vendimmarrjes për ligjshmërinë.

Kontrolli normativ i akteve të përgjithshme juridike nënkupton se përveç ligjeve, marrëveshjeve kolektive dhe programeve e statuteve të partive politike, identifikimi i të cilave si akte normative është e thjeshtë, para Gjykatës mund të kontestohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e akteve e llojeve të ndryshme të akteve tjera normative të cilat në mënyrë të përgjithshme rregullojnë çështje të caktuara (akte normative me fuqinë e ligjit, rregullore, urdhra, udhëzime, vendime etj. të autoriteteve shtetërore dhe

¹⁰ Shkariq Svetomir. "E drejta Kushtetuese komparative dhe maqedonase, Matica makedonska", 2004, f. 694

të autoriteteve të vetëqeverisjes lokale ose të organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike). Në lidhje me këtë është e rëndësishme të theksohet se Gjykata e pranon kompetencën edhe atëherë kur bëhet fjalë për akt i cili nuk e kënaq formën e aktit normativ, por është evidente se rregullon çështje të caktuara në mënyrë të përgjithshme.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kontrolli normativ i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në përputhje me standardet e vendosura të përgjithshme të gjykimit kushtetues, ndërkaq të sanksionuara edhe në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, realizohet sipas dy kriterëve themelore: së pari, si kontroll “represiv” ose si kontroll a posteriori, që do të thotë se Gjykata Kushtetuese mund ta vlerësoj kushtetutshmërinë dhe/ose ligjshmërinë vetëm pasi që ligji përkatësisht ndonjë akt tjetër normativ apo ndonjë akt i përgjithshëm është miratuar dhe ka hyrë në fuqi. Së dyti, kontrolli normativ realizohet edhe si kontroll abstrakt (principaliter) ose si kontroll konkret (incidenter) të kushtetutshmërisë. Në rastin e parë kontrolli normativ realizohet si kontest abstrakt midis normave të rankut më të lartë dhe më të ulët, pavarësisht asaj se norma e kontestuar a duhet të zbatohet në ndonjë rast konkret, dhe as atë se a është zbatuar ndonjëherë. Një kontroll të këtillë të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në rregullimin tonë kushtetues mund të inicioj gjithsecili, pavarësisht asaj se norma e kontestuar a e prek personin i cili e konteston normën apo një gjë të këtillë e bën meqë është i mendimit se ajo nuk është në përputhje me Kushtetutën. Në rastin e dytë, sa i përket kontrollit konkret, bëhet fjalë për kontroll të kushtetutshmërisë të cilin e inicion gjykata për shkak të vlerësimit të normës ligjore të cilën ajo duhet ta zbatoj në një lëndë konkrete për të cilën vendos, megjithatë konsideron se kjo normë nuk korrespondon me Kushtetutën, dhe në mënyrë të drejtpërdrejt nuk mund ta zbatoj Kushtetutën.

Rregullorja është e hapur për paraqitjen e iniciativave për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit nga çdo gjykatë përkatësisht gjyqtar.

Për më tepër, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për gjykatat kur gjykata e rregullt konsideron se ligji i cili duhet të zbatohet nuk është në përputhje me Kushtetutën, atëherë kontestin do ta zgjidh në bazë të dispozitave kushtetuese, të cilat mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejt në rastin konkret. Kjo në të vërtetë është një mundësi gjykatat e rregullta ta përjashtojnë ligjin jokushtetues, përmes zbatimit të drejtpërdrejt të dispozitave nga Kushtetuta. Në rast se dispozitat kushtetuese nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejt në ndonjë rast konkret, atëherë gjykata e rregullt e ka për detyrë ta pezullojë procedurën deri në miratimin e vendimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Kundër vendimit për pezullimin e procedurës, pala e ka të drejtën e ankesës, për të cilën vendos në procedurë urgjente gjykata më e lartë e rregullt. Sa i përket kontrollit konkret të kushtetutshmërisë, duhet të theksohet fakti se në Gjykatën Kushtetuese nga viti 1991 deri në vitin 2021 nuk është paraqitur asnjë iniciativë me çështje preliminare për kushtetutshmërinë e aktit juridik të paraqitur nga ana e gjykatës së rregullt lidhur me procedurën e cila zhvillohet para gjykatës së njëjtë.

Së këtejmi, në kuadër të kontrollit abstrakt, Gjykata Kushtetuese i miratoi vendimet më të rëndësishme doktrinare për sigurimin real të vlerave themelore të rendit kushtetues, duke filluar nga të kuptuarit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, ndarja e pushtetit, sundimi i ligjit, zgjedhjet e lira dhe demokratike, kështu deri në konstitucionalizimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë në vitin 2006 u përcaktua, ta konstitucionalizojë Konventën, në mënyrë e cila lidhet ngushtë me statusin e të drejtave të njeriut në rendin kushtetues. Gjykata u mbështet në faktin se aktet ndërkom-bëtare për të drejtat e njeriut, nga aspekti esencial, rregullojnë një materie ekskluzivisht

kushtetuese, përkatësisht kanë përmbajtje kushtetuese¹¹ dhe së këtejmi është legjitime të parashtrohet pyetja: a thua këto akte, veçanërisht Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duhet të kenë një status ndryshe nga të tjerat në rendin kushtetues të vendit?

Detyra e trajtimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në rendin kushtetues të RMV-së në mënyrë tjetër, dhe jo vetëm përmes prizmit të hierarkisë formale të akteve normative juridike, buron së paku prej dy shkaqeve që kanë të bëjnë me aspektet esenciale. Së pari, liritë dhe të drejtat e njeriut të njohura në instrumentet ndërkombëtare, në masë të madhe janë inkorporuar në dispozitat e Kushtetutës së RMV-së që përfshijnë më shumë se 1/3 e Kushtetutës dhe, së dyti, në përputhje me nenin 8 paragrafin 1 alineja 1 të Kushtetutës, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara në Kushtetutë, paraqesin **vlerë themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

Në një kontekst të këtillë, Gjykata Kushtetuese me Vendimin **U.nr.31/2006** nga data 01.11.2006 me të cilin e shfuqizoi dispozitën e Ligjit për tubime publike, Konventën e vuri në nivel të Kushtetutës me këtë argumentim:

Duke u nisur nga neni 8 paragrafi 1 alineja 1 të Kushtetutës sipas të cilit njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues janë edhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë, duke e pasur parasysh rëndësinë e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore jo vetëm si pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Maqedonisë, por për shkak të parimeve të përgjithshme mbi të cilat mbështetet dhe i promovon, **Gjykata vlerësoi se interpretimi i nenit 21 të Kushtetutës duhet të mbështetet në këto parime të përgjithshme juridike ...** Megjithatë, mënyra me të cilën është formuluar dispozita e kontestuar është krejtësisht ndryshe nga ajo në paragrafin 2 të nenit 11 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe për këtë shkak para Gjykatës u parashtrua pyetja për atë se ligjvënësi a ka pasur sukses në mënyrë të kuptueshme ta përcaktoj intensitetin e kufizimit të lirive të tjera, veçanërisht lirinë e lëvizjes, si bazë për “shpërndarjen” e tubimit. **Me fjalë të tjera, neni 11 paragrafi 2 i Konventës insiston në përcaktimin e “domosdoshmërisë” për kufizimin e të drejtës së tubimit të qetë për shkak të mbrojtjes së vlerave dhe të drejtave të tjera, që nënkupton se tubimi seriozisht i ka rrezikuar të drejtat e tjera. Dispozita e kontestuar e Ligjit, sipas Gjykatës, nuk përmban cilësi të këtillë dhe urdhër për autoritetet kompetente,** por formulim të përgjithshëm se me tubimin publik nuk duhet të kufizohen liritë dhe të drejtat e tjera, dhe veçanërisht liria e lëvizjes. Në këtë kontekst, Gjykata nuk është e mendimit se pengimi i komunikacionit në një rrugë për disa orë, qoftë me tubim statik ose me kolonë, mund të paraqes kufizim të lirisë së lëvizjes, nëse tubimi ka qëllim të qartë ta komunikojë mesazhin, nëse në qytet ka edhe rrugë të tjera nëpër të cilat mund të kalohet dhe ngjashëm. Për më tepër, dispozita e kontestuar lehtësisht mund të jetë bazë që autoriteti kompetent të identifikojë kufizim të lëvizjes sipas normave të akteve normative të komunikacionit edhe për pengimin më të vogël të komunikacionit, pikërisht meqë në atë normë nuk është përfshirë kriteri kualitativ ose urdhri për domosdoshmërinë e kufizimit të tubimit, dhe së këtejmi edhe indikatorë i qartë se qëllimi i ligjit është që tubimi të ketë sukses, dhe jo të pamundësohet. Sipas kësaj, edhe pse dispozita e kontestuar në shikim të parë duket vetëm si përshtetshmëri të asaj se si një tubim duhet të duket, sipas mendimit të Gjykatës, kjo dispozitë, në pjesën e dytë përmban baza tepër të gjëra për kufizimin e tij të cilave autoritetet mund t’u referohen me lehtësi. **Këto baza për kufizimin e tubimit, në mungesë të kriterëve për balancim, të drejtën e tubimit e pasqyrojnë si një punë të rrezikshme, që sipas Gjykatës, nuk mund të arsyetohet me asgjë.**

¹¹ Malinverni, G., The status of human rights treaties in domestic legal systems, in: The Status of International Treaties on Human Rights, Science and Technique of Democracy No.42, Venice Commission, Council of Europe Publishing, 2006

Për shkaqet e cekura, Gjykata konstatoi se dispozita e kontestuar e nenit 1-a në pjesën: “dhe së këtejmi nuk do të kufizohet e drejta e qytetarëve të cilët nuk marrin pjesë në tubimin publik për lëvizje të lirë dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë” nga Ligji për tubime publike **nuk është në përputhje me Kushtetutën, por në lidhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**”.

Pastaj, në Vendimin U.nr.**139/2010** nga data 15.12.2010 me të cilin shfuqizoi disa dispozita të caktuara nga Ligji për komunikime elektronike, Gjykata e përsëriti dhe plotësoi qëndrimin e njëjtë se interpretimi i Kushtetutës duhet të bazohet në parimet e përgjithshme juridike të përfshira në Konventë dhe **“të interpretuara në praktikën e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg”**.

2.1.1.1. STATUSI I PRAKTIKËS SË GJEDNJ

Për dallim nga neni 18 paragrafi 5, që ka të bëjë me detyrimin e gjykatave t'i respektojnë vendimet përfundimtare dhe ekzekutive të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që implikon se bëhet fjalë për vendime kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të të cilave mund të hapet procedurë para gjykatave vendase, në nenin 35 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për gjykatat, Gjykatës Supreme i përcaktohet kompetenca të vendos ndaj kërkesës së palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë dhe në procedurën për shkeljen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe **duke u nisur nga praktika gjyqësore** e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në vitin 2008 në Gjykatën Kushtetuese u paraqit një iniciativë me të cilën kontestohet kushtetutshmëria e kësaj dispozite ligjore nga aspekti i Amendamentit 25 të Kushtetutës nga i cili rezultoka se praktika gjyqësore nuk është burim i të drejtës përkatësisht se gjykatat duhet doemos të gjykojnë vetëm në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi pretendimin e iniciativës dhe me Aktvendimin U.nr. **104/2008** nga data 20.11.2008, vendosi që të mos hap procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitës së kontestuar, me gjetjen:

“...teksti i Konventës është ngushtë i lidhur bashkë me interpretimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata Supreme gjatë aplikimit të Konventës gjithsesi se nuk do ta arrij implementimin real të saj nëse fokusohet në kontekstin tekstual dhe në interpretimin e saj jashtë juridiksionit të Gjykatës së Strasburgut. Në të vërtetë, kjo do të thotë nëse gjykata vendase e interpreton dispozitën e Konventës siç shkruan pa mbajtur llogari dhe të ketë qasje në praktikën e Gjykatës së Strasburgut dhe në qëndrimet e saj parimore interpretuese, nuk do të mund ta siguroj mbrojtjen e të drejtës.”

Siç mund të shihet nga kjo që u tha më lartë, Gjykata Kushtetuese e shfrytëzoi mundësinë jo vetëm ta arsyetoj referimin në praktikën e Gjykatës Evropiane kur Gjykata Supreme vendos për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm, por edhe të ofroj një mesazh të qartë për gjykatat që në të gjitha rastet ta aplikojnë Konventën në përputhje me interpretimin e dispozitave të saj që është dhënë nga Gjykata Evropiane në vendimet e saj.

Efekti i këtij aktvendimi të Gjykatës Kushtetuese konsiston me atë se të gjitha dispozitat e përmendura nga ligjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës Evropiane u referohen paragrafëve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të artikuluara në praktikën e saj gjyqësore, kanë mbështetje të plotë kushtetuese. **Në këtë kuptim, praktika e GJEDNJ res interpretata shërben për zbatimin e drejtë të Konventës si pjesë e rendit të brendshëm juridik.**

Trajtimi i këtillë i praktikës së GJEDNJ nuk krijon kurrfarë kundërthëniesh nga aspekti i statusit dhe zbatimit të së drejtës materiale. Duke e pasur parasysh detyrimin kushtetues të gjykatave të vendosin në bazë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në përputhje me interpretimin e saj që pasqyrohet në paragrafët Gjykata e Strasburgut në vendimet e saj (neni 18 paragrafi 6 të Ligjit për gjykatat), për mosrespektimin dhe moszbatimin e paragrafëve të GJEDNJ me injorimin e tyre ose me të kuptuarit e gabueshëm në mënyrë evidente, pa mëdyshje se do të paraqiste bazë për ankesë kundër aktgjykimit deri te gjykata më e lartë për shkak të **zbatimit të gabueshëm të të drejtës materiale**. Me fjalë të tjera, shkelja e këtillë nuk do të ishte për shkak të moszbatimit të vendimit të GJEDNJ-së si burim i të drejtës, por për shkak të zbatimit të gabueshëm të dispozitës nga Konventa ashtu siç është interpretuar nga GJEDNJ.

Rëndësia e interpretimit gjyqësor të akteve ndërkombëtare gjatë zbatimit të tyre në rendin juridik të RMV-së në perspektivë rritet përmes formave të reja. Së këtijmi, me ratifikimin e Protokollit nr.16 ndaj KEDNJ, i cili hyri në fuqi në muajin gusht të vitit 2018 pas ratifikimit nga ana e 10 shteteve, do të hapet mundësia që Gjykata më e lartë e vendit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të kërkoj opinion këshillëdhënës për interpretimin e të drejtave të njeriut nga Konventa gjatë vendimmarrjes në një lëndë konkrete. Sipas kësaj, është e qartë se edhe gjykatat maqedonase e kanë detyrimin ta sigurojnë zbatimin e barabartë të të drejtës së Konventës “në hapësirën e vetme juridike të Evropës” për shkak të mbrojtjes të të drejtave të garantuara të gjithsecilit në juridiksion të shtetit nënshkrues. Për më tepër, me anëtarësimin që i paraprinë RMV-së në BE, gjykatat vendase do të kenë mundësi ta shfrytëzojnë procedurën e “vendimit preliminar” (preliminary rulings) me qëllim të pranimin të qëndrimeve interpretative të Gjykatës së BE-së gjatë vendimmarrjes në raste konkrete në të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt zbatohet e drejta e BE-së.

Kompetenca e Gjykatës për **vendimmarrje lidhur me kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve** është kompetencë e re e inkorporuar me Kushtetutën e vitit 1991. Në të vërtetë, këtu bëhet fjalë për kontrollin normativ të akteve konstituive (programi dhe statuti) të partive politike dhe Kushtetutës së RMV-së, me qëllim që me aktet e theksuara partiake të mos lejohet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues. Për dallim nga Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë dhe e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë nuk është kompetente të nxjerr vendime për ndalimin e veprimit të partisë politike, kur ajo vepron në mënyrë jo kushtetuese. Megjithatë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e programit dhe statutit të partisë politike në të vërtetë e ka veprimin e ndalimit të veprimit të partisë politike, meqë në bazë të vendimit të saj, Gjykata e Apelit, miraton aktvendim për ndërprerjen e ekzistimit të asaj partie.¹²

2.1.2. MBROJTJA E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE QYTETARIT

Mbrojtja e drejtpërdrejt kushtetuese gjyqësore e të drejtave individuale kushtetuese në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë u inkorporua përmes nenit 110 alineja 3 të Kushtetutës nga viti 1991, me të cilin Gjykatës Kushtetuese në mënyrë eksplicite iu përcaktua kompetenca “t’i mbrojë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të opinionit, asociimit politik dhe veprimit dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike”.

12 Shkariq Svetomir. “E drejta Kushtetuese komparative dhe maqedonase, Matica makedonska”, 2004, f. 699

Kjo dispozitë ndërlidhet me nenin 50 paragrafin 1 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se “çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë në procedurë e cila bazohet në parimet e prioritetit dhe emergjencës.”

Edhe pse është mjaft e qartë se neni 110 alineja 3 dhe neni 50 paragrafi 1 i Kushtetutës janë artikulime të konceptit për mbrojtje të drejtpërdrejtë të këtyre lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese dhe se ky koncept është huazuar nga tradita gjermane *Verfassungbeschwerde*, austriake *Beschwerden* dhe spanjolle *Recurso de Amparo*, në këto dispozita kushtetuese mbetën të pa artikuluar ose të pa artikuluar deri në fund disa elementë prej të cilëve varet fizionomia e plotë e procesit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese, kështu që edhe vet emërtimi i instrumentit i cili u fuqizua në kulturën bashkëkohore të konstitucionalizmit evropian, jo vetëm si emërtim, por edhe si model i mbrojtjes, me emrin universal në gjuhën angleze – *constitutional complaint*.

Kushtetuta nuk e rregullon atë se si do të emërtohet mjeti juridik për mbrojtje, kundër cilave akte ai mund të paraqitet, kush mund ta paraqesë dhe në cilat kushte, brenda cilave afate, kush do të jetë efekti i vendimit të Gjykatës Kushtetuese etj. Në mënyrë që të sigurohet qasje efektive në Gjykatën Kushtetuese dhe që të realizohet kjo kompetencë e saj kushtetuese, këto çështje duhej të rregullohen me aktin e mënyrës së punës dhe procedurës para Gjykatës Kushtetuese të nenit 113 nga Kushtetuta. Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese këto çështje i rregullon në kapitullin IV “Procedura e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të nenit 110 alineja 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë”. Edhe pse ky kapitull i përfshinë nenet 51-57, thuaja se të gjitha elementët relevantë që e përcaktojnë natyrën juridike të mjetit juridik për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese janë rregulluar në nenin 51, si vijon:

“Çdo qytetar i cili konsideron se me ndonjë akt ose veprim individual i është cenuar e drejta ose liria të përcaktuara në nenin 110 alineja 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese në afat prej 2 muajsh nga dita e dërgimit të aktit individual përfundimtar ose të plotfuqishëm, përkatësisht nga dita kur e ka kuptuar ndërmarrjen e veprimit me të cilin është bërë cenimi, por jo më vonë se 5 vjet nga dita e ndërmarrjes së tij.”

Ankesa jonë kushtetuese, sipas dispozitave të theksuara i ka këto karakteristika:

1. ajo emërtohet “kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave”;
2. ajo është mjet juridik për mbrojtje para Gjykatës Kushtetuese, kur sipas vlerësimit të personit të prekur ekziston cenim aktual dhe i drejtpërdrejt i lirive dhe të drejtave i kryer me akte ose veprime individuale të organeve të pushtetit publik përfshirë këtu edhe gjykatat;
3. ajo është mjet juridik me të cilin mbrohen vetëm disa të drejta themelore të njeriut dhe qytetarit të përcaktuara me Kushtetutë;
4. ajo mund të paraqitet edhe kundër aktit përfundimtar edhe kundër aktit të plotfuqishëm individual, përkatësisht madje edhe para se të absolvohen të gjitha mjetet juridike që mund të paraqiten kundër atij akti;
5. ajo mund të paraqitet në afat relativisht të shkurtër pas dërgimit të aktit përfundimtar ose aktit të plotfuqishëm individual përkatësisht nga të kuptuarit për ndërmarrjen e veprimit me të cilin është kryer veprimi.

Termi “ankesë” kushtetuese në këtë analizë përdoret si sinonim i “kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave”, me qëllim që të sugjerohet se midis tyre nuk ka dallim kuptimor, por vetëm dallim terminologjik dhe se emërtimi i mjetit juridik është irelevant sa i përket natyrës së tij juridike. Në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese madje ka pasur mundësi të përdoret termini *ankesë kushtetuese*, ashtu siç ky mjet juridik sot emërtohet në Kushtetutën e Serbisë, apo *padi kushtetuese*, siç emërtohet në Kushtetutën e Kroacisë, por me këtë mjet juridik nuk do të fitonim, e as nuk do të humbim asgjë. Nga aspekti normativ, që do të pasqyrohet edhe në një pasqyrë të shkurtër komparative, kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave konform nenit 51 të Rregullores është ankesë kushtetuese – edhe pse me një shtrirje të kufizuar dhe me dobësi të caktuara normative – meqë mjeti juridik me të cilin një person në mënyrë të drejtpërdrejt mund t’i qaset Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, në çdo vend emërtohet *constitutional complaint*: në këtë kuptim, është e qartë se gjatë finalizimit të modelit të mbrojtjes individuale të lirive dhe të drejtave në nenin 51 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese është bërë një recepsion i karakteristikave thelbësore të *ankesës kushtetuese* sipas traditës së deri atëhershme evropiane, e që nuk është kontestuese as në literaturën komparative, në të cilën Republika e Maqedonisë klasifikohet si vend i cili posedon ankesë kushtetuese.¹³ Megjithatë efektet e saj në përvojën 31 vjeçare të Maqedonisë janë më se modeste, ndërsa statistika është skajshëm dekurajuese për shpresat e njerëzve se do të mund t’i mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre para Gjykatës Kushtetuese. Restriktiviteti i Kushtetutës sa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, cilësia e kërkesave për mbrojtje, si dhe qasja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ndaj tyre dhe ndaj supstratit të të drejtave të njeriut janë faktorë të cilët secili në mënyrën e vet, ndikojnë në këtë gjendje, por ajo nga ana e saj, nuk ndikon mbi natyrën juridike të kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave si ankesë kushtetuese. Konsiderohet se zgjerimi i kompetencës të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë do ta radhiste në grupin e shumicës së vendeve evropiane në të cilat me ankesë kushtetuese mbrohen të drejtat themelore ose të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ndërsa një gjë e këtillë në mënyrë të paevitueshme do të ndikojë në tejkalimin e joefektivitetit ekzistues të ankesës kushtetuese.

Objekt i këtij teksti nuk është mbështetja ose kontestimi i reformës së mundshme dhe, mesa duket, reformës së nevojshme kushtetuese sa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese në drejtimin e duhur, por, nga ana tjetër, analiza e vlerës së sistemit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Kushtetuese, e cila krahas ankesës kushtetuese e përfshin edhe *actio popularis*, përkatësisht parashtresën (iniciativën) *individuale* për kontestimin e drejtpërdrejtë të kushtetutshmërisë të ligjit apo të ndonjë akti tjetër normativ. Pasqyrimi i atij sistemi në kontekstin komparativ zhvillimor, mesa duket, tregon se ai nuk është krijuar vetëm nga dobësitë dhe mangësitë, por se posedon disa efekte të rëndësishme kompensuese të cilat, nga ana tjetër, janë përfshirë në disa sisteme në të ashtuquajturat ankesa kushtetuese.

2.1.2.1. GJYKATA KUSHTETUESE DHE GJEDNJ

Është evidente se me vendimet themelore të lartpërmendura, Gjykata Kushtetuese në parim pranoi ta harmonizojë praktikën e saj me Konventën dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Mirëfilli, një gjë e këtillë mund të shihet në disa vendime të miratuara në vitin 2009 dhe 2010. Megjithatë, këto vendime tregojnë se, edhe pse është evidente dëshira e Gjykatës Kushtetuese që ta përdor Konventën dhe praktikën

¹³ Për shembull: Gentili, Gianluca, “A comparison of european systems of direct access to constitutional judges: exploring advantages for the italian constitutional court”, Italian Journal of Public Law, issue1, 2012, p.159
Harutyunian, Gagig and Mavcic, Arne, “The constitutional review and its development in the modern world”, Yerevan-Ljubljana, 1999` p.294

e Gjykatës Evropiane, një gjë është kjo të bëhet përmes kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit, dhe diçka tjetër të bëhet në procedurë sipas ankesës kushtetuese. Këto vendime janë të veçanta edhe në kuptimin e asaj se në të njëjtat përdoren aktgjykimet e njëjta të Gjykatës Evropiane në mënyrë që të mbështeten qëndrime të ndryshme. Ja për çka bëhet fjalë.

Është relativisht e lehtë të miratohet vendim i Gjykatës Kushtetuese në përputhje me qëndrimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kur edhe në të dyja rastet janë relevante parimet e njëjta, veçanërisht kur edhe në të dyja rastet shqyrtohet cilësia e një ligji. Në këtë kuptim, në mënyrë të njëjtë si edhe në rastin që kishte të bëjë me burgimin e përjetshëm, Gjykata me vendimin me të cilin shfuqizoi dispozita nga Ligji për komunikime elektronike me të cilat ishte vendosur kornizë për ndjekjen e fshehtë të komunikimeve, iu referua rasteve *Lordachi v. Moldova* и *Weber and Saravia v. Germany* dhe plotësisht i zbatoi standardet e zhvilluara minimale që sipas CJEDNJ duhet të parashikohen me ligj që të shmanget abuzimi i pushtetit. Në një rast tjetër të kontrollit abstrakt **U.nr.194/2008** nga data 25.03.2009, Gjykata e vlerësoi kushtetutshmërinë e dispozitës së Ligjit për procedurë kontestimore e cila parashikon mundësi që Gjykata t'i dënojë palët të cilat i keqpërdorin të drejtat e tyre procesuale, si dhe përfaqësuesit e tyre nëse janë përgjegjës për keqpërdorimin e këtyllë. Dispozita u kontestua si e paqartë dhe e paparashikueshme, me mundësi që të çoj deri në kufizim arbitrar të lirisë së shprehjes së avokatëve nga ana e gjyqtarit. Gjykata Kushtetuese iu referua rasteve *Nikula v. Finland* dhe *Kiprianou v. Cyprus* me qëllim që t'i theksoj parimet e përgjithshme të artikuluar në ato raste, si e para, se avokatët kanë përgjegjësi të caktuar për ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit dhe për shpërndarjen e drejtë të drejtësisë dhe, së dyti, se liria e tyre e shprehjes proporcionalisht mund të kufizohet me qëllim të realizimit të atij qëllimi legjitim. Gjykata vlerësoi se dispozita e kontestuar ligjore i pasqyron parimet e njëjta të përgjithshme dhe duke konsideruar se gjyqtari mund ta aplikoj si mjet të fundit për ruajtjen e rendit në sallën e gjyqit, konstatoi se ajo nuk është në kundërshtim me Kushtetutën duke mos u futur në analiza të mëtutjeshme të cilësisë së kësaj dispozite. Megjithatë, *Nikula* dhe *Kiprianou* janë raste në të cilat Gjykata Evropiane, përkundrazi, rëndësi shumë më të madhe i vë parimit se liria e shprehjes së avokatit është aq e rëndësishme që mund të kufizohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Në këto lëndë, Gjykata e Strasburgut, pasi që i shqyrtoi rrethanat përmes testit të proporcionalitetit, përcaktoi se me dënimin e avokatëve në ato raste është shkelur e drejta e tyre e lirisë së shprehjes.

Gjykata Kushtetuese, kohë më parë, pati mundësi për një analizë të këtyllë suptile në procedurën sipas ankesës kushtetuese në lëndën **U.nr. 107/2010** nga data 16.02.2011, në të cilën avokati konsideronte se me dënimin penal për shpifje për shkak të kinse deklarave të pavërteta për palën kundërshtarë të dhëna në kontestin civil gjatë dhënies së ndihmës juridike klientit, i është shkelur e drejta e lirisë së shprehjes. Gjykata miratoi vendim mazhoritar me të cilin e refuzoi kërkesën. Në këtë vendim Gjykata përsëri iu referua rasteve *Nikula* dhe *Kiprianou* që ta artikulojë parimin se liria e shprehjes së avokatëve nuk është e pakufizuar. Kundrejt kësaj, duke e pranuar këtë parim të përgjithshëm, autori i këtij teksti në mendimin e tij të veçantë iu referua aktgjykimëve të njëjta të Gjykatës Evropiane në mënyrë që ta mbështesë qëndrimin e kundërt, përkatësisht, se analiza e proporcionalitetit të dënit të shqiptuar në rrethanat konkrete, çon në konkluzionin se liria e shprehjes së avokatit është shkelur në thelbin e saj.

Theksi esencial i dallimeve në këtë lëndë të Gjykatës konsiston me atë që nuk është e mjaftueshme që Gjykata Kushtetuese vetëm t'u referohet rasteve të caktuara të CJEDNJ dhe ta harmonizojë praktikën e vet vetëm në kontekstin e qëndrimeve dhe parimeve të përgjithshme të asaj gjykate, por nevojitet ta harmonizojë metodologjinë e testit të proporcionalitetit. Në lëndët në të cilat vlerësohet kushtetutshmëria e akteve normative, Gjykata Kushtetuese është relativisht e sigurt nga aspekti i çështjes nëse në mënyrë përkatëse i

interpreton aktgjykimet e GJEDNJ dhe nuk ka hapësirë për dialog efektiv, duke e pasur parasysh atë se këto lëndë të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të paraqiten para GJEDNJ. Megjithatë, në lëndët në të cilat Gjykata Kushtetuese vendos sipas kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave (ankesë kushtetuese), masën e harmonizimit, përkatësisht interpretimin përkatës, përfundimisht e përcakton GJEDNJ.

Për fat të keq, në këtë kontekst Gjykata Kushtetuese, përkundrajt të gjitha pritshmërive, në disa raste të rëndësishme të cenimit të të drejtave të njeriut, në vend që t'i mbroj ia lejoi vetvetes jo vetëm në mënyrë esenciale të mos i dëgjojë kërkesat e viktimave të cenimit, por madje ajo vet, me veprimet e veta, ishte burim i cenimit të të drejtave të garantuara të njeriut me Konventën Evropiane. Së këtijmi, Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën e z- Makraduli për mbrojtjen e të drejtës së tij të shprehjes të cenuar me vendim gjyqësor me të cilin është përcaktuar se ka bërë shpifje kundër funksionarit publik me gjetjen se në këtë rast nuk është cenuar kjo e drejtë, ndërsa më vonë, sipas aplikimit të tij, Gjykata e Strasburgut përkundrazi, ka konstatuar se ekziston cenim i të drejtës së tij. E njëjta ndodhi edhe me rastin e z.-Gelevski, kërkesën e të cilit për mbrojtjen e lirisë së shprehjes Gjykata Kushtetuese e refuzoi, ndërsa Gjykata e Strasburgut konstatoi cenim të këtillë. Kjo dukuri shihet edhe në rastin e Manastirit Stavroplagjial dhe znj. Mizhimakovska, kur Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën e saj për mbrojtjen e lirisë së shprehjes fetare përmes moslejimit të regjistrimit të grupit fetar, meqë ajo kërkesën e ka paraqitur në emër të grupit dhe jo në emrin e vet, ndërsa Gjykata e Strasburgut më vonë konstatoi se në këtë rast ekziston cenimi i të drejtës së lirisë së shprehjes; i njëjtë është rasti edhe me komunitetin Bektashian i cili pas mospasjes që ta mbroj të drejtën e vet para Gjykatës Kushtetuese, drejtësinë e fitoi në Gjykatën e Strasburgut. Në rastin e z-Selmani, kryetar i Shoqatës së Gazetarëve, në të cilin ai kërkonte mbrojtje të të drejtës së shprehjes së lirë të cenuar me largimin e gazetarëve nga salla plenare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti cenim, por një cenim të këtillë konstatoi Gjykata e Strasburgut, e cila njëkohësisht konstatoi edhe cenim të të drejtës për gjykim të ndershëm meqë Gjykata Kushtetuese nuk mbajti diskutim publik për atë lëndë, ndërsa për një gjë të këtillë ka qenë e obliguar me Rregulloren (Neni 55). Në rastin e fundit, Gjykata Kushtetuese jo vetëm që nuk e ka dhënë mbrojtjen e kërkuar, por edhe vet ajo i ka cenuar të drejtat e aplikantit të garantuara me Konventën.

Këto pikëpamje janë dekurajuese në kontekst të dëshirës, aq shpesh e përsëritur tek ne, të ndryshohet Kushtetuta dhe ankesa kushtetuese të zgjerohet në të gjitha të drejtat kushtetuese, meqë dëshmohet se niveli i ulët dhe vëllimi i mbrojtjes i të drejtave kushtetuese nga neni 110 alineja 3 të Kushtetutës, nuk është pasojë (vetëm) e përfshirjes së ngushtë të ankesës kushtetuese, por e dështimit serioz të përbërjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në periudhën e kaluar, mund të themi në mospasjen e kapacitetit që të krijohet shumicë kritike e cila gjykon në dobi të të drejtave të njeriut në përputhje me pikëpamjet dhe parimet e përgjithshme që i krijoi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

PROCEDURA PARA GJYKATËS KUSHTETUESE

Në përputhje me nenin 11 dhe 12 të Rregullores, **procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme nënligjore** ngritet me aktvendim të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa me rastin e iniciativës së paraqitur. Secili mund të paraqes iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor (actio popularis).

Nuk ka dispozitë për kufizim ose për përcaktim se kush mund të paraqesë iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë kështu që nxirret konkluzioni se edhe vet gjyqtarët mund ta bëjnë një gjë të këtillë.

Në lidhje me mundësinë që Gjykata Kushtetuese të ngre procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor vëmendjen e tërheq dispozita e nenit 16, paragrafi 2 të Rregullores së Gjykatës sipas së cilës, veç tjerash, nëse iniciativa është paraqitur nga parashtgues i panjohur do të konsiderohet se nuk është paraqitur, të cilën gjë sekretari do ta konstatojë në shkresën. Parashtrohet pyetja pse Gjykata Kushtetuese nuk ngre procedurë edhe për iniciativë të këtillë, nëse tanimë mund të ngre procedurë sipas detyrës zyrtare.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme nënligjore, funksion i radhës për nga rëndësia i Gjykatës Kushtetuese është **mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit**. Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'i bëhet vërejtje sa i përket përfshirjes së vogël të lirive dhe të drejtave mbrojtja e të cilave i është dhënë në kompetencë Gjykatës Kushtetuese.

Dispozita e nenit 110, alineja 3 të Kushtetutës nuk është në kundërshtim me dispozitën e saj të nenit 50, sipas të cilave çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë në procedurë të bazuar mbi parimet e prioritetit dhe emergjencës. Garantohet mbrojtje gjyqësore e ligjshmërisë së akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera të cilat ushtrojnë autorizime publike. Qytetari ka të drejtë të njoftohet me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe të kontribuojë në mënyrë aktive, individuale ose bashkë me të tjerë në drejtim të avancimit dhe mbrojtjes së të njëjtave.

Në të vërtetë, kushtetubërësi parashikon sistem të dyfishtë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut para gjykatave të rregullta ndërsa për të drejta të caktuara para Gjykatës Kushtetuese. Pse është kështu nuk është e qartë, dhe pse nuk ka mundësi të gjitha të drejtat dhe liritë të cilat janë parashikuar si vlera themelore në Kushtetutë të mos vlerësohet mbrojtja e tyre para Gjykatës Kushtetuese. Nuk është e qartë pse kushtetutbërësi bën **dallim midis qytetarit dhe njeriut** për tu thirr në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë e specifikon **qytetarin**, para gjykatave dhe Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 50 dhe nenin 100 të Kushtetutës e cila i mbron liritë dhe të drejtat e **njeriut dhe qytetarit**.

Sipas nenit 51 të Rregullores të Gjykatës Kushtetuese çdo qytetar i cili konsideron se me akt ose veprim të veçantë i është cenuar e drejta ose liria e përcaktuar në nenin 110, alineja 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese në afat prej dy muajsh nga dita e dërgimit të aktit të veçantë përfundimtar dhe të plotfuqishëm, përkatësisht nga dita kur e ka kuptuar ndërmarrjen e veprimit me të cilin është kryer cenimi, por jo më vonë se 5 vjet nga dita e ndërmarrjes së tij.

Në përputhje me këtë dispozitë të Rregullores vetëm personi fizik i cili është qytetar i RMV-së mund të paraqesë kërkesë për liritë dhe të drejtat. Në rastin konkret kur si paraqitës mund të paraqitet personi juridik atëherë obligim i gjykatës është ta hedhë poshtë kërkesën. Kufizimin të cilin e bën Rregullorja rezulton nga dispozita e nenit 110 alineja 3 të Kushtetutës së RMV-së, ku është përcaktuar se Gjykata Kushtetuese i mbron vetëm liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit.

Nuk është e njohur se pse vetëm personave fizikë por jo edhe personave juridikë ju mundësohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive, gjithsesi se në këtë drejtim nevojiten ndryshime si në kushtetutë ashtu edhe në Rregullore. Kjo aq më shumë kur sugjerohet se në Kushtetutë janë inkorporuar të gjitha aktet ndërkombëtare siç është Deklarata Universale dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

Çka ndodh me termin “NJERI”, i cili term e nënkupton personin që nuk është shtetas i RMV-së, (neni 4 i Kushtetutës), do të thotë i huaj. A ka mundësi ai të ngre iniciativë për kushtetutshmërinë dhe kushtetutshmëri dhe ligjshmëri të ndonjë akti të përgjithshëm, përgjigja është pozitive. A ka mundësi ai të ngre kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave? Përgjigja është po ashtu pozitive. Dispozita e Kushtetutës nga neni 110 alineja 3 përcakton se Gjykata Kushtetuese mbron disa të drejta dhe liri të caktuara të njeriut dhe qytetarit, që nënkupton se i është dhënë mundësia njeriut, (të huajt) të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tij të cilat janë specifikuar në nenin 110 alinenë 3.

Në përputhje me Rregulloren, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave Gjykata Kushtetuese vendos, sipas rregullit, në bazë të diskutimit të mbajtur publik (neni 55) në të cilin thirren pjesëmarrësit e procedurës dhe Avokati i Popullit, ndërsa sipas nevojës mund të thirren edhe persona të tjerë, organe ose organizata. Nëse disa nga pjesëmarrësit në diskutimin publik nuk marrin pjesë, ndërsa janë thirrur në rregull, atëherë diskutimi mund të mbahet.

Sipas njohurive që i kemi nga këqyrja e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në numrin më të madh të procedurave të kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nuk janë mbajtur diskutime publike. Veprimi i këtillë është në kundërshtim me nenin 55 të Rregullores së Gjykatës, në përputhje me të cilën, siç është theksuar më lartë, me rregull, për kërkesat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave vendoset pas diskutimit të mbajtur publik.

Nga analiza e dispozitave të Rregullores mund të konkludohet se mbajtja e diskutimeve publike i është lënë vullnetit të Gjykatës, përkatësisht aty nuk është precizuar në cilën mënyrë vendoset për mbajtjen ose mos mbajtjen e diskutimit publik. Nuk ka dyshime se diskutimi publik është instrument për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike dhe se ai kontribuon për përhapjen e kulturës juridike që është e rëndësishme për zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe është obligatorë kur vendoset për kërkesat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave. Mos mbajtja e diskutimit publik duhet të jetë përjashtim dhe jo praktikë, siç është tani dhe duhet të ekzistojë shkak i arsyeshëm të cilin Gjykata do ta justifikojë se pse nuk do të mbajë diskutim publik.

Gjatë analizës së procedurës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, u hap çështja, nëse shkelja e kryer me aktin dhe veprimin e veçantë rezulton nga ndonjë ligj jokushtetues apo nga ndonjë dispozitë e tij, atëherë a mundet Gjykata Kushtetuese ta anulojë ose shfuqizojë Ligjin jokushtetues ose dispozitën e tij me të cilën është bërë shkelja në procedurën e njëjtë në të cilën vendos për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive. Në Kushtetutë dhe Rregullore nuk janë parashikuar dispozita me të cilat imponohen kufizime të Gjykatës që të dyja procedurat të zhvillohen veç e veç. Në përputhje me këtë nuk shohim pengesa për Gjykatën Kushtetuese për bashkimin e të dy procedurave në një, meqë kjo do ta rrisë cilësinë e vendimit, dhe njëkohësisht do të aplikohet edhe praktika e GJEDNJ – vlerësimi i ligjshmërisë në pjesën e cilësisë së ligjit dhe përputhjes së tij me Kushtetutën. Në favor të kësaj teze është edhe dispozita e nenit 14 të Rregullores, sipas së cilës Gjykata Kushtetuese ka mundësi edhe vet (sipas detyrës zyrtare) të ngre procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit, përkatësisht kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit normativ ose aktit tjetër të përgjithshëm.

Kush dhe si inicohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese që ajo të vendosë për **konfliktin e kompetencave midis pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, midis organeve/autoriteteve të Republikës dhe bashkësive të vetëqeverisjes lokale**, si dhe për **çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë**, në Kushtetutë nuk ka dispozita të këtilla. Kur nuk ka kufizime në këtë drejtim atëherë nënkuptohet se të gjithë personat e interesuar mund të paraqiten si kërkues të mundshëm, ndërsa në Rregullore në detaje është sqaruar kompetenca e këtillë e Gjykatës.

2.3.

VENDIMMARJA E GJYKATËS KUSHTETUESE

Llojet e akteve

Aktet e Gjykatës Kushtetuese janë instrumente juridike përmes të cilave Gjykata e realizon kompetencën dhe veprimtarinë e saj. Llojet e akteve të Gjykatës Kushtetuese janë specifikuar në nenin 112 të Kushtetutës (kjo ka të bëjë vetëm me vendimet) dhe në nenin 69 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese miraton, vendime, aktvendime dhe konkluzione. Gjykata Kushtetuese miraton vendime kur vendos për thelbin e çështjes, përkatësisht për thelbin e kontestit, të parashikuara me Kushtetutë. Aktvendimet që i miraton gjykata, për dallim nga vendimet, kanë rëndësi procedurale dhe jo thelbësore dhe të njëjtat janë parashikuar me Rregulloren e Gjykatës njëjloj si edhe konkluzionet të cilat miratohen lidhur me veprimet që ndërmerren gjatë procedurës.

VEPRIMI JURIDIK I VENDIMEVE

Veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar me dispozitat e Kushtetutës së RMV-së dhe me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese. Për dallim nga kjo, veprimi juridik i vendimeve në periudhën kohore nga viti 1963 deri në vitin 1991 ishte rregulluar me Kushtetutat e vitit 1963 dhe 1974 që të dy ligjet për Gjykatën Kushtetuese.

Veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese varet nga lloji i vendimit. Kështu që, nëse bëhet fjalë për vendim të Gjykatës me të cilin është anuluar një ligj ose ndonjë dispozitë e tij apo ndonjë akt i përgjithshëm nënligjor ose ndonjë dispozitë e tij, atëherë veprimi i tij është retroaktiv nga dita e publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ex tunc). Sipas këtij rregulli, vendimet e këtilla të Gjykatës veprojnë jo vetëm në të ardhmen por edhe në mënyrë retroaktive, nga momenti i miratimit të ligjit të anuluar ose të ndonjë akti tjetër normativ. Për dallim nga vendimet anuluese, veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese me të cilat shfuqizohet një ligj ose ndonjë dispozitë e tij apo ndonjë akt i përgjithshëm nënligjor ose ndonjë dispozitë e tij (vendime shfuqizuese) ka të bëjë vetëm për të ardhmen. Kjo nënkupton se ligji i shfuqizuar ose akti i përgjithshëm nënligjor pushon së zbatuari dhe pushon të prodhojë veprim juridik ex nunc (nga shfuqizimi e tutje), ndërsa pasojat nga zbatimi i tij mbesin deri në shfuqizimin.

Segmenti i parë e inicion pyetjen se a ka Gjykata Kushtetuese kompetencë për anulimin e dokumenteve. Përgjigjja është negative. Për dy segmentet e tjerë duke e pasur parasysh se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të bëjnë me akte dhe veprime të cilave u referohet anulimi përgjigjja është pozitive, në pjesën e kompetencës së Gjykatës.

Anulimi është veprim i cili e përjashton aktin juridik nga rendi – sistemi juridik, dhe ai akt tanimë nuk prodhon veprim juridik.

Kushtetuta e RMV-së në nenin 112 e parashikon mundësinë Gjykata Kushtetuese të shfuqizojë ose anulojë ndonjë ligj nëse konstaton se i njëjti nuk korrespondon me Kushtetutën. Ajo do të shfuqizojë ose anulojë ndonjë akt tjetër normativ apo akt të përgjithshëm, marrëveshje kolektive, statut ose program të partisë politike apo shoqatës nëse konstaton se të njëjtat nuk korrespondojnë me Kushtetutën ose me ligjin. Veprimi i vendimeve të shfuqizuara ose anuluar prodhojnë veprim juridik në përputhje me rregullin përgjithësisht të pranuar për sundimin e së drejtës edhe atë nga dita e publikimit të vendimeve në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe të njëjtat janë përfundimtare dhe ekzekutive.

Secili e ka mundësinë të kërkojë anulim të ndonjë akti të veçantë kur Gjykata Kushtetuese ka anuluar ndonjë ligj, akt normativ ose ndonjë akt tjetër mbi të cilin është miratuar ai akt me caktimin e afatit prej 6 muaj nga dita e publikimit të vendimit të Gjykatës në Gazetën Zyrtare. Nga ana tjetër, ekziston mundësia e aplikimit të institutit kthim në gjendjen e mëparshme për shmangien e pasojave nga anulimi i aktit, nëse me ndryshimin e aktit të veçantë të nenit 81, paragrafi 1 të Rregullores, nuk mund të shmangen pasojat nga akti i anuluar nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Duke e pasur parasysh kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të caktuara nga neni 110 alineja 3, ajo krahas konstatimit për shkeljen eventuale e përcakton mënyrën e shmangies së pasojave nga zbatimi i aktit ose veprimit të veçantë, me të cilin është kryer shkelja.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Nga aspekti i ekzekutimit, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë disa karakteristika thelbësore. Ato janë përfundimtare dhe ekzekutive. Përveç kësaj ato janë edhe të detyrueshme. Gjithsecili me të cilin kanë të bëjnë këto vendime është i detyruar t'i ekzekutojë.

Me ekzekutimin vendimi realizohet në praktikë. Kur bëhet fjalë për vendimet e Gjykatës Kushtetuese, me ekzekutimin shmanget nga rendi juridik ligji jokushtetues ose ndonjë dispozitë e tij si dhe akti normativ jokushtetues ose joligjor apo ndonjë dispozitë e tij.

Sipas dispozitave të nenit 86 të Rregullores, vendimet e Gjykatës Kushtetuese i ekzekuton miratuesi i ligjit, i aktit tjetër normativ ose aktit të përgjithshëm që me vendim të Gjykatës është anuluar, ose shfuqizuar.

Vendimet me të cilat Gjykata vendos lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara në Kushtetutë i ekzekuton organi ose organizata që e ka miratuar aktin e veçantë e që me vendim të Gjykatës është anuluar, përkatësisht organi ose organizata që e ka ndërmarrë veprimin të cilin Gjykata Kushtetuese me vendim ka konstatuar se e drejta dhe liritë janë shkelur, ky detyrim është në drejtim të fuqizimit të pavarësisë së Gjykatës dhe gjyqtarëve.

Gjykata Kushtetuese e ka për detyrë ta monitorojë ekzekutimin e vendimeve të saj, dhe sipas nevojës, të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta sigurojë ekzekutimin e tyre.

Pa dyshim se Qeveria mund të siguroj efikasitet në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, vetëm me monitorimin e tekstit të vendimeve të saj. Prandaj, vendimet e Gjykatës duhet të argumentohen në detaje dhe në mënyrë të thelluar. Kjo do t'ju mundësojë që të pasqyrohet mënyra e ekzekutimit të tyre.



PUNA E GJYKATËS KUSHTETUESE

3.1.

EFIKASITETI


Lëndë në punë

Instituti për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të Projektit “Gjykata Kushtetuese – Mbrojtëse e Sundimit të së Drejtës”, e monitoroi punën e Gjykatës Kushtetuese në periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2020 deri në korrik të vitit 2021. Nga të dhënat e fituara me monitorimin e punës së Gjykatës Kushtetuese, të pasqyruara në Raportin e punës së Gjykatës Kushtetuese nr.1, 2 dhe 3¹⁴, konstatuam se në punë ka pasur gjithsej 172 lëndë, prej të cilave 156 iniciativa për ngritje të procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të ndonjë akti tjetër normativ, dhe 16 kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

Në mënyrë plotësuese, Gjykata nuk ka shqyrtuar asnjë propozim për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave.

Numri prej gjithsej 172 lëndë në punë për periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2020 deri në korrik të vitit 2021, nuk flet për ekzistimin e mbingarkimit të Gjykatës me punë. Me fjalë të tjera, mesatarisht çdo gjyqtar raportues në periudhën e cekur ka shqyrtuar rreth 22 lëndë, përkatësisht nga dy lëndë në nivel mujor, e që gjithsesi nuk është indicie për mbingarkim me punë. Nga ana tjetër gjatë nxerrjes së këtij konstatimi u udhëhoqëm nga kriteri “numri i lëndëve në punë”, pa u futur në analizë sa i përket kompleksitetit dhe përmbajtjes së tyre.

NUMRI I LËNDËVE NË PUNË 10.2020 - 8.2021



Në pjesën e punës për iniciativa është konstatuar mungesë të procedurave të ngritura me iniciativë të Gjykatës Kushtetuese. Paraqitës në numër më të madh të iniciativave për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme nënligjore, janë qytetarët. Gjatë monitorimit të seancave të

14 Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese nr.1 <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/us-kvar-talen-izveshtaj-okt20-jan211.pdf>

Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese nr.2 <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/uskvar-talenizvestajfevruariapril21.pdf>

Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese nr.3 https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/US_kvar-talenizvestaj_3.pdf

Gjykatës Kushtetuese mund të konkludohet se gjyqtarët, gjatë shqyrtimit të lëndëve të veçanta, vinë në përfundim se ekzistojnë një sërë probleme me dispozita të caktuara në më shumë ligje, e që ua jep mundësinë që ata vet të grenë procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Kjo çon në konkluzionin se ka nevojë për një proaktivitet më të madh të gjyqtarëve në këtë drejtim. Për hir të vërtetës, edhe pse jashtë periudhës së raportimit, Gjykata Kushtetuese, në vitin 2020 për herë të parë procedoi sipas iniciativës së saj (proprio motu), duke e kontestuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë të pesë akteve normative me fuqinë e ligjit, me ç'rast vendosi të ngre procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të tre prej tyre.

Gjykata, për shkak të sqarimit të gjendjes faktike dhe juridike, për iniciativa të caktuara, në secilën fazë të procedurës, mund të vendos se a të mbaj seancë përgatitore. Në periudhën kohore të raportimit, Gjykata, në 6 raste e ka shfrytëzuar këtë mundësi të Rregullores dhe ka mbajtur seancë përgatitore. Praktika e mbajtjes së seancave përgatitore është vendosur në vitin e fundit dhe paraqet një ndryshim pozitiv në punën e Gjykatës.

Gjatë analizës së lëndëve mund të konkludohet se numri i iniciativave të paraqitura dhe të shqyrtuara para Gjykatës në masë të konsiderueshme ndryshon nga numri i kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave. Me qëllim të përcaktimit se bëhet fjalë për një tendencë të vazhdueshme, i analizuam të dhënat e Gjykatës Kushtetuese nga viti 1991 deri në fund të vitit 2020. Së këtijmi, numri i iniciativave të paraqitura, në nivel vjetor, mesatarisht është rreth 215, ndërsa numri i kërkesave mesatarisht është 11 lëndë. Kjo flet për njohuritë e vogla të qytetarëve për këtë mjet juridik, për një numër të vogël të të drejtave dhe lirive të cilat mund të mbrohen në këtë mënyrë dhe mospasje besim tek qytetarët ndaj Gjykatës Kushtetuese, kur vendos për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave. Për më tepër, gjatë funksionimit të saj thuaja se 30-të vjeçare, Gjykata Kushtetuese, përfundimisht me muajin dhjetor të vitit 2020, ka pranuar gjithsej 333 kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave nga ana e qytetarëve, prej tyre janë zgjidhur 313 lëndë, me ç'rast, në 49 raste, Gjykata e ka refuzuar kërkesën duke mos gjetur se është bërë shkelje e lirive dhe të drejtave, ndërsa në 4 raste miratoi vendim në të cilin përcaktohet shkelje në të cilën janë thirr paraqitësit. Në numrin më të madh të rasteve (243) Gjykata e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së supozimeve procesuale-juridike për vendimmarrje ose jokompetencë, ndërsa në mënyrë administrative kanë përfunduar 17 lëndë. Sipas kësaj, ky institut juridik në sistemin juridik maqedonas nuk mund të konsiderohet si një mjet efektiv juridik, në kuptimin e nenit 13 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Sipas kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, në përputhje me nenin 55 të Rregullores, Gjykata Kushtetuese sipas rregullit vendos në bazë të diskutimit të mbajtur publik. Në diskutimin publik thirren pjesëmarrësit e procedurës dhe Avokati i Popullit, ndërsa sipas nevojës mund të thirren edhe persona të tjerë, organe ose organizata. Në diskutimin publik paraqitësi i kërkesës ka të drejtë ta prezantojë çështjen e tij dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ta informoj Gjykatën me të gjitha faktet relevante për vendimmarrje. Së këtijmi, nuk përjashtohet mundësia në diskutimin publik të prezantohen edhe prova dhe informacione të reja për të cilat Gjykata nuk ka qenë në dijeni në procedurën paraprake, ndërsa të njëjtat janë të rëndësishme për vendimmarrjen meritorë të lëndës. Për dallim nga numri gjithnjë e më i shpeshtë i seancave përgatitore, kur Gjykata vendos sipas iniciativave, Gjykata ka mbajtur vetëm një diskutim publik (një diskutim publik është konvokuar) në bazë të kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, edhe pse kur vendos për të njëjtat, sipas rregullit një gjë të këtillë duhet ta bëjë në bazë të diskutimit të mbajtur publik.

Në tremujorin e fundit të monitorimit është përcaktuar se për katër lëndë Gjykata nuk ka miratuar vendim, për shkak se propozimet për vendimmarrje sa u përket këtyre lëndëve nuk e kanë pasur shumicën e nevojshme. Shkaku për një gjë të këtillë ka të bëjë


me përfundimin e mandatit të tre gjyqtarëve kushtetues më 31 maj. Që atëherë Gjykata punon me përbërje jo të plotë me 6 gjyqtarë, ndërsa për miratimin e vendimit nevojitet shumica e votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, përkatësisht minimum 5 vota. Meqë nga përfundimi i mandatit të gjyqtarëve e deri më sot nuk janë zgjedhur gjyqtarë të rinj, ndërsa kanë kaluar më shumë se 3 muaj, konsiderojmë se një gjë e këtillë është e palejueshme, sepse ndikon negativisht mbi efikasitetin e punës së Gjykatës dhe shkakton grumbullim të lëndëve. Nga ana tjetër, aludon në problem me procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, e cila nuk është rregulluar në detaje.

Lëndë për të cilat janë marr vendime

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve Gjykata vendosi të ngre gjithsej 13 procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ndërsa për 63 lëndë u miratuan aktvendime për mosngritje të procedurës. U hodhën poshtë 72 iniciativa dhe 10 kërkesa për të drejtat dhe liritë. Gjykata miratoi 1 aktvendim për pezullimin e procedurës dhe 3 aktvendime për pezullimin e ekzekutimit të akteve ose veprimeve të veçanta, të miratuara në bazë të ligjit.

Duke vendosur në mënyrë meritore për iniciativat, u miratuan gjithsej 10 vendime për shfuqizim dhe 1 për anulim në procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në pjesën e vendimmarrjes për kërkesat lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut, u miratuan 2 vendime, me ç'rast me njërin u refuzua kërkesa e ankimesit, meqë nuk është gjetur shkelje të lirive dhe të drejtave, ndërsa në vendimin e dytë kërkesa është marr në konsideratë dhe është përcaktuar shkelja e të drejtës së jetës së përbashkët familjare, si pjesë përbërëse e të drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare të garantuar me nenin 40, paragrafin 1 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenin 8, paragrafin 1 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

VENDIMMARRJA



Kohëzgjatja e procedurave

Kohëzgjatja mesatare e procedurave (nga paraqitja e iniciativës, kërkesës, propozimit, deri në përfundimin e procedurës), për lëndët për të cilat janë miratuar akte përfundimtare nga Gjykata Kushtetuese, në periudhën kohore të raportimit, ndërsa llogaritur nga dita e paraqitjes së tyre, (pavarësisht fillimit të këtij projekti), mesatarisht është 9 muaj për tremujorin e parë dhe të dytë dhe 11 muaj për tremujorin e tretë.

Nëse merren parasysh të gjitha rrethanat në të cilat punon Gjykata Kushtetuese, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave nga paraqitja e iniciativave, kërkesave, propozimeve, e deri në përfundimin e të njëjtave sipas lëndëve, konsiderojmë se periudha kohore prej 11 muaj kohëzgjatje mesatare e procedurave marr në përgjithësi nënkupton një periudhë të gjatë të procedimit, dhe kjo mund të vlerësohet si reduktim të efikasitetit të Gjykatës në punë. Gjithsesi, duke i analizuar çështjet veç e veç, vetëm në pjesën e kohëzgjatjes së procedurave (duke mos u futur në përmbajtjen e lëndëve), mund të shihet se kohëzgjatja më e madhe për një lëndë është plot 98 muaj, ndërsa kohëzgjatja më e shkurtër brenda të cilës është marr vendimi për lëndën është 1 muaj.

Rëndësi jashtëzakonisht të madhe gjatë dhënies së vlerësimit relevant sa i përket kohëzgjatjes së procedurës ka vlerësimi i thelbit të lëndëve të cilat shqyrtohen. Në mënyrë që të jepet vlerësim i drejtë, duhet të bëhet analizë thelbësore e lëndëve, duke e marr parasysh kompleksitetin e tyre dhe të gjitha elementet e tjera të cilat çojnë në zvarritjen e procedurës.

Në sistemin juridik të RMV-së nuk ekziston instrument apo mekanizëm për revidimin e kohëzgjatjes së madhe të procedurave para Gjykatës Kushtetuese, me të cilin do të mund të vlerësohet kohëzgjatja e procedurave, në kuptimin e asaj se a është kënaqur standardi “në kohë të arsyeshme”. Duke e pasur parasysh gjendjen e këtillë konsiderojmë se vetëm GJEDNJ është në pozitë ta vlerësojë këtë element edhe atë për lëndë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. GJEDNJ nuk i procedon lëndët të cilat janë in abstracto (actio popularis) dhe në këtë drejtim në mënyrë të bazuar parashtrohet pyetja: A do ta ndërmer ajo kompetencën për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës për ato lëndë?

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese


Në praktikë, monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës realizohet në atë mënyrë që secili që ka interes juridik për ekzekutimin e ndonjë vendimi të caktuar, dërgon kërkesë me të cilën e njofton Gjykatën se vendimi i tij nuk është ekzekutuar. Nëse kërkesa është e rregullt, atëherë formohet lëndë me shenjë “I” në kuadër të së cilës sekretari i gjykatës do të kërkojë njoftim të nevojshëm nga miratuesi i aktit ose nga ndonjë subjekt tjetër për ekzekutimin e vendimit. Në rast se nuk pranon njoftim për ekzekutimin e vendimit, atëherë sekretari i Gjykatës, në përputhje me nenin 87 të Rregullores, do të kërkojë nga Qeveria e RMV-së ta sigurojë ekzekutimin e vendimit. Konsiderojmë se Gjykata doemos duhet të ketë një rol më aktivë në monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të saj, me atë që nuk do të pres t’i paraqitet kërkesë se vendimi nuk është ekzekutuar, kështu që nga institucionet kompetente për ekzekutimin e vendimit do të kërkojë njoftim për veprimet e ndërmarra në lidhje me ekzekutimin e tij.

Puna e gjyqtarëve kushtetues

Në kuadër të monitorimit të punës së gjyqtarëve kushtetues u konstatua se gjatë shpërndarjes së lëndëve (iniciativave) aplikohet sistemi me radhitje alfabetike, sipas mbiemrit të gjyqtarëve, me ç’rast nuk patëm mundësi të konstatojmë se gjatë shpërndarjes së lëndëve a është mbajtur llogari për kriterin e kompleksitetit të lëndëve edhe pse në Rregullore ekzistojnë dispozita që kanë të bëjnë me shpërndarjen e lëndëve të cilat nuk janë mjaft precize dhe të qarta. Nga të dhënat e fituara nga monitorimi i punës së Gjykatës, të cilat janë pasqyruar në grafikun në vijim, mund të përcaktohet dallimi i numrit të lëndëve të çdo gjyqtari raportues. Kjo ka të bëjë me më shumë faktorë si vijon: kryetari i Gjykatës nuk paraqitet në rolin e gjyqtarit-raportues (nuk pranon lëndë), kryetarit dhe dy gjyqtarëve të tjerë u ka skaduar mandati më datë 31.5.2021 dhe një pjesë e gjyqtarëve, në interval të caktuar kohor nuk kanë qenë në punë për shkaqe të ndryshme (pushim mjekësor, pushim vjetor etj.). Në mënyrë plotësuese, në muajin nëntor të

vitit 2020 u bë zgjedhja e gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, e cila nga data 1.6.2021 u bë kryetare e Gjykatës Kushtetuese.

GJYQTAR - RAPORTUES I LËNDËVE



Në përputhje me nenin 25 të Rregullores, gjyqtari i cili ka votuar kundër vendimit apo i cili konsideron se ai duhet të mbështetet në baza të tjera juridike, mund ta veçoj mendimin e tij dhe ta arsyetoj me shkrim. Nga analiza e të dhënave rezulton se numri i përgjithshëm i mendimeve të veçuara është 14, prej të cilave 10 janë individuale dhe 4 të përbashkëta për më shumë gjyqtarë. Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese Sali Murati veçohet nga të tjerët për nga numri i mendimeve individuale të veçuara. Për më tepër, është evidente se tre gjyqtarë, në periudhën kohore të raportimit, nuk kanë veçuar asnjë mendim. Numri i madh i mendimeve të veçuara të gjyqtarëve flet se vendimet të cilat i ka miratuar Gjykata, veçanërisht sa u përket lëndëve me interes më të madh për publikun, shpeshherë janë miratuar pa shumicë të madhe dhe me qëndrime dhe argumente juridike të ndryshme.

3.2.

TRANSPARENCA DHE PUBLICITETI

Sipas nenit 84 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, transparenca në punën e Gjykatës sigurohet me njoftim përmes mjeteve të informimit publik për mbajtjen e diskutimeve publike, ndërsa sipas vlerësimit të gjykatës edhe për mbajtjen e seancës gjyqësore dhe seancës përgatitore, me prezencë të pjesëmarrësve në procedurë dhe të personave të tjerë, të personave nga organet dhe organizatat dhe përfaqësues të mjeteve të informimit publik për vendimet e gjykatës për çështje në interes të opinionit të gjerë publikë.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, përmes monitorimit të implementuar mbi punën e Gjykatës Kushtetuese, mund të konstatohet si vijon: Në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese janë bërë gjithsej 148 publikime, prej të cilave 108 janë komunikata për punën

në seanca, 31 janë njoftime për takime të mbajtura dhe takime pune, 2 janë njoftime për pjesëmarrje në konferenca dhe vizita zyrtare, 2 kanë të bëjnë me njoftimin për zgjedhjen e kryetarit të ri të Gjykatës Kushtetuese, 3 publikime kanë të bëjnë me shpalljen për punësim dhe vendimin për zgjedhjen e kandidatëve dhe 2 publikime kanë të bëjnë me Raportin vjetor dhe Llogarinë përfundimtare.

Gjykata Kushtetuese, në periudhën e raportimit, nuk ka mbajtur asnjë konferencë për media, për shkak të gjendjes me pandeminë në RMV, megjithatë ka pasur komunikim të vazhdueshëm me të njëjtat, duke i informuar për punën rrjedhëse. Në mënyrë plotësuese, u botua Monografia e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së dhe dy përmbledhje të vendimeve, si burim i përhershëm për njoftimin e publikut me vendimet, opinionet profesionale dhe qëndrimet e saj.

Siç mund të vërehet nga kjo që u tha më lartë, Gjykata është një institucion transparent me, internet (ueb faqe) mirë të rregulluar e cila rregullisht përditësohet. Gjatë analizës së ueb faqes, është me rëndësi të theksohet se sistemi i kërkimit është plotësisht funksional dhe mundëson kërkim të lehtë dhe gjetjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme, madje edhe nga persona të cilët kanë njohuri modeste në përdorimin e internetit për nevojat e informimit personal.

Vërehet një vëllim i ngushtë i informacioneve me karakter publik të cilat mund t'i jep Gjykata. Listën e informacioneve me karakter publik të Gjykatës Kushtetuese e përbëjnë këto grupe të informacioneve: vendime përfundimtare të Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, numri i iniciativave të paraqitura dhe rendi i ditës i seancave të Gjykatës Kushtetuese. Parashtrohet pyetja: pse në listën e informacioneve me karakter publik nuk është përfshirë numri i kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, numri i propozimeve të paraqitura për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës dhe paraqitësit e propozimeve; pastaj numri i seancave të mbajtura gjyqësore dhe seancave përgatitore, dita e mbajtjes etj.? Këto informacione janë pasqyruar në Raportet vjetore të punës së Gjykatës Kushtetuese edhe pse nuk janë përfshirë në Listë. Së këtëjmi, çështja ka të bëjë me qasjen të këto informacione për njësi më të shkurtra kohore (muaj, tremujor, gjysmë viti), nëse paraqitet interes për të njëjtat.

Në ueb faqe është postuar një Udhëzues i detajuar për përpilimin e kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të këtij fakti mund të konkludohet se Gjykata, i përkushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të specifikuara në nenin 110, alineja 3 të Kushtetutës.

Publiku në punën e gjykatës, përkatësisht në diskutimin publik, seancën gjyqësore dhe seancën përgatitore mund të përjashtohet nëse një gjë të këtillë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, ruajtjes së sekretit shtetërorë, sekretit zyrtarë ose sekretit afarist, mbrojtjes së moralit publik si dhe në raste të tjera të arsyeshme që i përcakton gjykata (neni 85 i Rregullores).

Sipas të dhënave nga tryeza e mbajtur e rrumbullakët përkushtuar transparencës së Gjykatës Kushtetuese, në të cilën morën pjesë edhe gazetarë, u theksua se deri në vitin 2014 Gjykata Kushtetuese ishte njëra nga institucionet më transparente në Republikë. Veç tjerash, lejohej regjistrimi audio dhe vizual i seancave nga ana e mediave. Gjykata kishte person – zëdhënës i ngarkuar për marrëdhënie me publikun. Zëdhënësi shpeshherë ka raportuar para mediave dhe subjekteve të tjera të interesuara në lidhje me punën e gjykatës dhe vendimet e saj. Në vitin 2014, me vendim të Gjykatës, kjo praktikë u braktis, me arsyetimin se kameramanët e pengojnë punën e gjyqtarëve. Atëherë gjykata pjesërisht u mbyll për publikun – për qytetarët në shërbimin e të cilëve është. Kjo situatë relativisht u tejkalua, për çka u bindëm në mënyrë të drejtpërdrejt gjatë ndjekjes së seancave të Gjykatës. Me fjalë të tjera, lejohet regjistrimi i mediave me kamera, në fillim

të seancave, dhe përdorimi i celularëve nga ana e gazetarëve, gjatë kohës së seancës. Ka ndryshime pozitive edhe sa u përket diskutimeve të gjyqtarëve gjatë justifikimit të opinioneve dhe qëndrimeve. Megjithatë, është evidente se ka akoma gjyqtarë të cilët kanë diskutime në numër të vogël.

Transparenca në punën e Gjykatës Kushtetuese është e rëndësishme sepse arrihet vizibiliteti, përmirësimi i imazhit publik dhe rritja e besimit në Gjykatë, dhe para së gjithash për shkak të transparencës gjatë miratimit të vendimeve të Gjykatës të cilat janë në interes për opinionin e gjerë publik.

Për hir së vërtetës, edhe pse akoma nuk është gjetur ndonjë zgjidhje që do të mundësojë gazetarët dhe kameramanët ta kryejnë punën e tyre, ndërkohë të mos u pengojnë gjyqtarëve gjatë arsyetimit të qëndrimeve dhe opinioneve të tyre në seanca, duam të theksojmë se ka tendencë për ndryshime në drejtim pozitiv. Gjykata është transparente për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve. Në lidhje me këtë veçanërisht potencojnë se Gjykata, me Institutin për të Drejtat e Njeriut, lidhën Memorandum për bashkëpunim. Në përputhje me këtë Memorandum përfaqësuesit e Institutit i monitorojnë seancat publike. Nga ana tjetër, duhet të theksohet se publiku asnjëherë nuk është përjashtuar (përveç në përputhje me nenin 85 të Rregullores) nga seancat e Gjykatës, por ndalimi ka të bëjë vetëm me regjistrimin e seancave nga ana e përfaqësuesve të mjeteve të informimit publik.

Kur bëhet fjalë për regjistrimin, sipas Rregullores së Gjykatës (neni 26, paragrafi 3), përveç mbajtjes së procesverbalit në seancë në të cilën për lëndë të caktuara për të cilat parashtrihen pyetje më të rëndësishme kushtetuese – juridike, sigurohet stenografim, përkatësisht regjistrim me mangetofon (audio) të rrjedhës së diskutimit. Audio regjistrimi është pjesë përbërëse e procesverbalit (neni 45, paragrafi 4).

Gjykata nuk ka person të punësuar për marrëdhënie me publikun (zëdhënës). Punët e zëdhënësit i kryen njëri nga këshilltarët, krahas punëve të përcaktuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të gjykatës. Me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës është parashikuar vendi i punës për marrëdhënie me publikun, por ky vend pune akoma nuk është plotësuar.

4

KONKLUSION

Shkenca dhe praktika bashkëkohore kushtetuese juridike e paralajmëron nevojën e fuqizimit të pavarësisë së gjykatave kushtetuese, veçanërisht meqë të njëjtat kujdesen për sendërtimin e kushtetutshmërisë në shtetin konkret dhe për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara të njeriut.

Duke e ndjekur praktikën e GJEDNJ, aktet e punës së Gjykatës Kushtetuese, përmes realizimit të kompetencës së saj, i miraton vet Gjykata Kushtetuese dhe në këtë mënyrë e përforcon pavarësinë e saj.

Kushtetutëbërësit e Kushtetutës, kanë parashikuar që Gjykata Kushtetuese për realizimin e punës së saj për një gjë të këtillë të miratojë akt, ndërsa gjyqtarët kushtetues këtë akt e emërtuan Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së.

Çdo revidim i tekstit të akteve të këtilla, parë nga aspekti i nevojës për zbatimin e përvojave të fituara nga praktika e punës së Gjykatës Kushtetuese dhe sugjerimeve të ekspertëve nga kjo fushë, me debate paraprahe të ekspertëve është i mirëseardhur.

Kushtetuta e RMV-së parashikon kompetencë të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut edhe atë gjykatat e rregullta përmes ligjeve procesual dhe material, ndërsa Gjykata Kushtetuese vetëm disa të drejta dhe liri të caktuara të parashikuara në nenin 110 alineja 3 të Kushtetutës, në mesin e të cilave mbrojtja nga diskriminimi në baza të përcaktuara në mënyrë të saktë. Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi parashikon më shumë baza të diskriminimit sesa Kushtetuta. Për këtë nevojiten amendamente kushtetuese për zgjerimin e listës së bazave për procedimin e tyre nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Nevojitet të zgjerohet lista e bazave të diskriminimit në Kushtetutën e RMV-së. Në mënyrë plotësuese, nevojitet një debat i gjerë i ekspertëve për çështjet se a duhet të zgjerohet edhe lista e të drejtave dhe lirive, mbrojtja e të cilave kërkohet nga Gjykata Kushtetuese dhe me aplikimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ-së dhe mekanizmave ekzistues juridik në sistemin juridik kombëtar a nuk sigurohet mbrojtje cilësore dhe e mjaftueshme e të drejtave dhe lirive të njeriut?

Gjykata Kushtetuese nuk mund ta ndërmarr rolin e instancës së mundshme të katërt.

Meqë nuk i është dhënë mundësia personit juridik të kërkojë mbrojtje të të drejtave të parashikuara me Kushtetutë, është e nevojshme të bëhet korrigjim në këtë pjesë. Më adekuate do të ishte të bëhet ndryshimi i fjalëve “njeri” dhe “qytetar” me fjalën “gjithsecili” siç është edhe në tekstin e KEDNJ. Në të kundërtën vihet në pikëpyetje mundësia e zbatimit të Konventës. Mundësia e dytë është plotësimi i Kushtetutës me termin “personi juridik”, dhe rrjedhimisht ky ndryshim duhet të implementohet edhe në Rregullore.

Gjykata Kushtetuese ia jep KEDNJ-së karakterin konstituiv me Vendimin e saj U.nr.31/2006 nga data 01.11.2006, i cili është miratuar pas iniciativës së paraqitur për vlerësimin e kushtetutshmërisë, por parashtrohet pyetja, me zbatimin e të njëjtës në praktikë, a mund të konsiderohet se e zgjeron këtë rëndësi edhe tek mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut. Vlerësimi parcial i veprimit konstitucional të KEDNJ hap dyshime serioze. Së këtëjmi, nevojitet të unifikohet qasja sa i përket rëndësisë dhe implementimit të KEDNJ.

Në Kushtetutë dhe Rregullore nuk është parashikuar mundësia e përjashtimit të gjyqtarëve. Një gjë e këtillë duhet të rregullohet me Rregulloren e Gjykatës, si sa i përket kërkesës së palëve në procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, ashtu edhe sa i përket kërkesës së vet gjyqtarëve, gjithsesi përmes prezantimit të argumenteve. Vendimin për përjashtim mund ta miratojë kryetari i Gjykatës ose me propozim të tij vendimin mund ta miratojnë gjyqtarët. Megjithatë, zgjidhja për tejkalimin e problemit

për plotësimin e numrit të gjyqtarëve të përjashtuar, mund të bëhet përmes zgjedhjes “ad hoc” të gjyqtarëve nga ana e Kuvendit, në mënyrë të njëjtë si edhe në procedurën e rregullt.

Statusi i gjyqtarëve dhe pavarësia e tyre është kategori kushtetuese. Pagat e gjyqtarëve janë rregulluar me ligj dhe e njëjta duhet t'i përfshijë edhe shtesat tjera në pagë të cilat tani janë objekt të Rregullores. Është e saktë se në këtë mënyrë fuqizohet pavarësia, por duke e pasur parasysh karakterin ligjor të këtyre të drejtave të njëjtat duhet të rregullohen në më shumë ligje ekzistues, dhe jo në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese.

Shtesat në pagën e gjyqtarëve kushtetues, lartësia e tyre dhe pamundësia e zvogëlim-it të pagave të tyre, duhet të rregullohen me Ligjin për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë.

Në përputhje me Rregulloren, gjatë shpërndarjes së lëndëve (iniciativave) aplikohet sistemi sipas radhës së alfabetit, sipas mbiemrit të gjyqtarëve, me ç'rast nuk patëm mundësi të konstatojmë se gjatë shpërndarjes së lëndëve a është mbajtur llogari për kriterin kompleksitet i lëndëve edhe krahas faktit se në Rregullore ekzistojnë dispozita për shpërndarjen e lëndëve të cilat, megjithatë, nuk janë mjaft precize dhe të qarta. Shpërndarja e lëndëve si njëra nga bazat për pavarësinë e fuqizuar, në mënyrë të qartë duhet të trajtohet me Rregulloren në mënyrë që të shmangen të gjitha keqpërdorimet eventuale. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh kompleksiteti dhe lloji i lëndëve.

Gjykata mban llogari për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të saj, vetëm nëse secili që ka interes juridik për ekzekutimin e ndonjë vendimi të caktuar, paraqet kërkesë me të cilën e njofton Gjykatën se vendimi i tij nuk është ekzekutuar. Në këtë rast, nga ana e Gjykatës kërkohet njoftim nga miratuesi i aktit ose nga ndonjë subjekt tjetër për ekzekutimin e vendimit. Çka ndodh me lëndët në të cilat nuk është ekzekutuar vendimi i Gjykatës, ndërkaq nuk është paraqitur kërkesë për ekzekutimin e tij?

Në pjesën e mosekzekutimit të vendimeve, Gjykata Kushtetuese duhet të ketë rol proaktiv në drejtim të njoftimit të publikut në lidhje me gjendjet me ekzekutimin. Në këtë mënyrë publiku i gjerë do të njoftohet me faktin e mosekzekutimit të vendimeve nga ndonjë organ/autoritet i caktuar dhe do të ketë mundësi ta vlerësoj sjelljen jopërkatese eventuale.

Kushtetutshmëria e Ligjit me të cilin u intervenua në ndonjë të drejtë ose liri të caktuar duhet të vlerësohet në procedurën e njëjtë në të cilën konstatohet shkelja eventuale e asaj të drejte ose lirie. Për këtë shkak duhet të rishikohet Rregullorja, në drejtim të bashkimit të dy procedurave (procedura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave dhe procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve normative dhe akteve të tjera të përgjithshme) në një procedurë të vetme.

Akti i mos zgjedhjes së gjyqtarëve të rinj, pas përfundimit të mandatit të tre gjyqtarëve kushtetues më 31 maj, ndikon negativisht mbi efikasitetin e punës së Gjykatës dhe shkakton rritje të numrit të lëndëve.

Në mënyrë plotësuese, aludon në problemin me procedurën, e cila nuk është rregulluar në detaje në pjesën e njoftimit të Kuvendit për ndërprerjen e mandatit të gjyqtarit, edhe pse Gjykata në kohë të duhur, tre muaj para përfundimit të mandatit e njoftoi Kuvendin. Në mënyrë që të përforcohet vendosja e këtillë nevojitet që kjo të inkorporohet në Rregullore si detyrim i Gjykatës Kushtetuese. Duhet menjëherë të bëhet zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që të plotësohen vendet vakante dhe të përmbushet detyrimi kushtetues i numrit të gjyqtarëve kushtetues. Kjo nevojitet që të sigurohet punë efektive dhe efikase e Gjykatës Kushtetuese, por edhe të jepet mundësia e prezantimit të pluralizmit të mendimeve dhe qëndrimeve gjatë miratimit të vendimeve.

Nga monitorimi i punës së Gjykatës Kushtetuese në periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2020 deri në korrik të vitit 2021, mund të konstatohet se Gjykata më së shumti ka vepruar ndaj iniciativave të paraqitura (156), ndërsa numri i kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut është i papërfillshëm (16). Njëherësh, në këtë konotacion është me rëndësi të theksohet se mbajtja e seancave përgatitore është një dukuri më e shpeshtë e Gjykatës Kushtetuese kur vendos për iniciativat e paraqitura, ndërsa nga ana tjetër, Gjykata ka mbajtur vetëm një diskutim publik për (16) kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut edhe pse sipas rregullit Gjykata sa u përket këtyre kërkesave duhet të vendos në diskutim publik. Megjithatë, mos mbajtja e diskutimit publik duhet të jetë përjashtim, dhe jo praktikë, siç është aktualisht, dhe doemos duhet të ketë shkak të arsyeshëm të cilin Gjykata do ta justifikojë se pse nuk do të mbaj diskutim publik.

Në kontekst të punës së Gjykatës Kushtetuese, është me rëndësi të apostrofohet se në tremujorin e fundit mesatarisht kohëzgjatja e procedurave nga paraqitja e iniciativave, kërkesave dhe propozimeve e deri në përfundimin e këtyre lëndëve është 11 muaj e që marr në përgjithësi është një periudhë e gjatë e veprimit/procedimit. Gjatë dhënies së vlerësimit relevant lidhur me kohëzgjatjen e procedurës duhet të bëhet një analizë esenciale e lëndëve duke pasur parasysh më shumë indikatorë siç është kompleksiteti i procedurës, lloji i lëndës dhe faktorët e tjerë të cilët mund të ndikojnë mbi vendimmarrjen.

Sa i përket transparencës së punës së Gjykatës Kushtetuese ajo vlerësohet përmes transparencës së saj për publikun, bashkëpunimit me mediat, bashkëpunimit me institucionet shtetërore, sektorin joqeveritar dhe me të gjithë qytetarët e interesuar për punën e saj. Gjykata Kushtetuese rregullisht i publikon informacionet që kanë të bëjnë me punën e saj në ueb faqen e Gjykatës, po ashtu, ajo është e hapur për bashkëpunim, dhe rregullisht u përgjigjet kërkesave të paraqitura për qasje të lirë deri te informacionet.

Sa i përket transparencës proaktive, përkatësisht publikimit të informacioneve me karakter publik të cilat janë në interes të publikut, këtu mund të konstatohet përfshirja restriktive e informacioneve të cilat mund të merren nga ueb faqja e Gjykatës, kështu që në këtë drejtim si rekomandim, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së saj, Gjykata Kushtetuese duhet ta ketë parasysh zgjerimin e listës së informacioneve të cilat do të jenë të aksesshme për qytetarët.

BIBLIOGRAFI

1. Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese numër 1, Instituti për të Drejtat e Njeriut <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/us-kvartalen-izveshtaj-okt20-jan211>.
2. Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese numër 2, Instituti për të Drejtat e Njeriut <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/uskvartalenizvestajfevruariapril21.pdf>
3. Raport për punën e Gjykatës Kushtetuese numër 3, Instituti për të Drejtat e Njeriut
4. Opinioni i Komisionit të Venecias (CDL-AD(2014)026) [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)026-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)026-e)
5. Opinioni i Komisionit të Venecias (CDL-AD(2010) 038-e) [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2010\)038](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2010)038)
6. Omejec, Jasna. "Raporti përfundimtar Misioni i ekspertëve të TAIEK për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga ana e Gjykatës Kushtetuese", Shkup 2018.
7. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 52/91.
8. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, U.nr.84/2009 nga data 10.02.2010, U.nr.116/2017 nga data 27.06.2018, U.nr.57/19 nga data 29.05.2019, U.nr.230/2020 nga data 12.11.2020
9. Shkariq, Svetomir, "E drejta kushtetuese komparative dhe maqedonase", Matica makedonska, 2004,
10. Gentili, Gianluca, "A comparison of european systems of direct access to constitutional judges: exploring advantages for the italian constitutional court", Italian Journal of Public Law, issue1, 2012.
11. Harutyunian, Gagig and Mavcic, Arne, "The constitutional review and its development in the modern world", Yerevan-Ljubljana, 1999`
12. Malinverni, G., The status of human rights treaties in domestic legal systems, vo: The Status of International Treaties on Human Rights, Science and Technique of Democracy No.42, Venice Commission, Council of Europe Publishing, 2006

